



Financuar nga
Bashkimi Evropian



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

RAPORTI I MONITORIMIT TË

PJESËMARRJES POLITIKE, SOCIALE DHE
EKONOMIKE TË TË RINJVE NË SHQIPËRI

2024



Hulumtues: [Era Sherifaj](#)

Kontribues: [Jonida Alite](#), [Ana Mullanji](#)

Grafika dhe Faqosja: [Enxhi Rexhepi](#)

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Zëra më të Fortë për Zgjedhje më të Mira – Një Hub Rinor për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë (YHWBT)”, i cili zbatohet nga fondacioni “Ana dhe Vlade Divac” në Serbi, organizata “Përtej Barrierave” në Shqipëri, “Aleanca Rinore - Krusevo” në Maqedoninë e Veriut, organizata “Prima” në Mal të Zi, “Fondacioni i Vullnetarëve për Komunitetin” në Turqi, “Instituti Demokraci për Zhvillim” në Kosovë dhe “Instituti për Zhvillimin Rinor KULT” në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Seria e raporteve të mëparshme është përgatitur nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (2016–2023), si partner zbatues i projektit “Punësimi i të Rinjve në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi”. Në vitin 2024, Partnerët Shqipëri vazhdon përgatitjen e Raportit Kombëtar si anëtar i rrjetit “Hub Rinor për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë”, si dhe në bazë të marrëveshjes kontraktuale me organizatën “Përtej Barrierave”.

Ky publikim është përgatitur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë vetëm ato të autorit/autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bashkimit Evropian ose të Agjencisë Ekzekutive Evropiane të Arsimit dhe Kulturës (EACEA). As Bashkimi Evropian dhe as EACEA nuk mund të mbahen përgjegjës për to.

TABELA E PËRMBAJTJES

1

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

2

**TË DHËNA MBI PJESËMARRJEN POLITIKE,
SOCIALE DHE EKONOMIKE TË TË RINJVE**

3

**ANALIZA DHE KRAHASIMI I TË DHËNAVE
PËRGJATË 9 VITEVE TË MONITORIMIT**

4

REKOMANDIME

5

**SHTOJCA 1 – METODOLOGJIA E
STUDIMIT**

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i Monitorimit të Pjesëmarrjes Politike, Sociale dhe Ekonomike të të Rinjve në Shqipëri është përgatitur çdo vit që prej vitit 2016. Ai analizon të dhënat kryesore mbi sfidat në pjesëmarrjen e të rinjve dhe shërben si një mjet konkret i bazuar në të dhëna për politikëbërësit dhe organizatat rinore.

Raporti kombëtar kontribuon në përgatitjen “Indeksit të Pjesëmarrjes së të Rinjve” një raport vjetor rajonal i Monitorimit të Pjesëmarrjes Politike, Sociale dhe Ekonomike të të Rinjve, i cili paraqet situatën e përgjithshme të pjesëmarrjes së të rinjve në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi.

Politikëbërësit, organizatat rinore dhe aktorë të tjerë të interesuar në çështjet që lidhen me rininë mund të përdorin **Indeksin e Pjesëmarrjes së të Rinjve (IPR)** për të vlerësuar situatën aktuale dhe për të identifikuar fushat që kanë nevojë për përmirësim. Që nga fillimi tij në vitin 2016, përgatitja dhe publikimi i rregullt i IPR-së ka mundësuar monitorimin e vazhdueshëm të progresit të pjesëmarrjes së të rinjve në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi (në vijim në tekstin e mëposhtëm referuar si rajoni i BP&T).

Raporti i secilit shtet paraqet sfidat dhe rrugëtimin e tyre drejt përmirësimit, ndërsa IPR-ja ofron një kornizë krahasuese për të identifikuar problemet e përbashkëta dhe për të informuar mbi zgjidhjet e mundshme.

Raporti synon të ofrojë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të mundësive për të rinjtë përmes lentes së 25 indikatorëve që matin pjesëmarrjen politike, ekonomike dhe sociale.

- **Dimensioni politik** i referohet mundësive që kanë të rinjtë për t'u përfshirë në proceset politike, për t'u informuar mbi punën e qeverisë, parlamentit dhe bashkive, si dhe për të marrë pjesë në rrjete rinore dhe për tu zgjedhur në poste politike. Indikatorët e përzgjedhur për të matur pjesëmarrjen e të rinjve në këtë dimensionin përfshijnë prezencën e ministrave dhe zëvendësministrave të rinj në qeveri, deputetë të rinj në parlament dhe kryebashkiakë të rinj. Tregues të tjerë vlerësojnë disponueshmërinë e mjeteve online për informim dhe pjesëmarrje në vendimmarrje të qeverisë, parlamentit dhe bashkive; si dhe ekzistencën e strukturave rinore në nivel kombëtar dhe lokal.

- **Dimensioni ekonomik** i referohet shkallës së përfshirjes ose, në të kundërtën, përjashtimit të të rinjve nga tregu i punës. Ky dimension mat shkallën e aktivitetit, pjesëmarrjes në forcën e punës, punësimin, vetëpunësimin të të rinjve, shkallën e papunësisë dhe papunësisë afatgjatë, të rinjtë NEET (Të rinj 15-29 as në Punësim, as në Arsim ose Trajnim), si dhe shpenzimet totale të qeverisë për programet e nxitjes së punësimin.

- **Dimensioni social** i referohet pjesëmarrjes aktive të të rinjve në jetën sociale. Ai vlerësohet mbi bazën indikatorëve për integrimin e të rinjve në komunitet përmes arsimit formal dhe joformal, kushteve që mund të çojnë në përjashtimin e mundshëm të të rinjve nga jeta sociale, për shkak të varfërisë, varësisë nga sistemi i ndihmës sociale apo kohës së kaluar në burg ose në institucionet e riedukimit. Indikatorët përkatësisht përfshijnë përqindjen e të rinjve në rrezik varfërie, të rinjve në burg dhe të rinjve pjesë e sistemit të ndihmës sociale. Në konsideratë janë marrë edhe tregues të lidhur me arsimin, si shkalla e regjistrimit dhe e diplomimit në arsimin e lartë, si dhe përqindja e të rinjve me arsim të avancuar. Gjithashtu janë përfshirë në raport shpenzimet totale të qeverisë për programet e mbrojtjes sociale.

Raporti monitorimit është një mjet konkret që mund të përdoret nga institucionet shtetërore dhe Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të) për të identifikuar dhe adresuar në mënyrë sistematike sfidat më urgjente të pjesëmarrjes aktive të të rinjve në Shqipëri. Ai kontribuon në:


- krahasimin e të dhënave sipas indikatorëve kryesorë të pjesëmarrjes së të rinjve në tre dimensione: politik, ekonomik dhe social;
- monitorimin e progresit të pjesëmarrjes së të rinjve në Shqipëri ndër vite;
- ndërmarrjen e iniciativave advokuese në nivel lokal për zbatimin e politikave dhe programeve që synojnë përmirësimin e pjesëmarrjes së të rinjve.

Raporti Kombëtar për Shqipërinë për vitin 2024 paraqet një analizë të të dhënave të mbledhura përmes hulumtimit dhe kërkesave zyrtare për informacion dërguar institucioneve përgjegjëse si: *Ministria e Arsimit dhe Sportit; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministër Shteti për Rininë dhe Fëmijët, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministër Shteti për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Instituti Kombëtar i Statistikave, si dhe 61 Bashkive në vend.*

Të dhënat e këtij raporti janë përfshirë gjithashtu në raportin rajonal vjetor “Indeksi i Pjesëmarrjes së të Rinjve”, i cili pasqyron dhe krahason të dhënat nga shtatë vende (Shqipëri, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi, Kosovë, Bosnja dhe Hercegovina dhe Turqi) anëtare të rrjetit “Hub-i Rinor për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë”.



“Ndërsa iniciativat e ndërmarra për të rinjtë në Shqipëri gjatë viteve të fundit kanë arritur progres modest, veçanërisht në dimensionin ekonomik, avancimi në pjesëmarrjen sociale dhe politike mbetet i kufizuar, duke theksuar nevojën për më shumë iniciativa efektive të targetura specifikisht për të rinjtë”.



SHËNIM SQARUES PËR TË DHËNAT E DIMENSIONIT SOCIAL DHE EKONOMIK

Gjatë viteve, dhe deri aktualisht për përgatitjen e këtij raporti, dhe veçanërisht për indikatorët e dimensionit ekonomik, si dhe disa prej indikatorëve të dimensionit social, jemi bazuar kryesisht në statistikën zyrtare të ofruara nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT).

Gjatë hartimit të Raportit të vitit 2024, u vu re se INSTAT kishte rishikuar disa prej të dhënave zyrtare të vitit 2023 pas publikimit fillestar të tyre. Këto ndryshime u bënë në vitin 2025, pas publikimit të Raportit të vitit 2023, i cili është bazuar në vlerat fillestare të ofruara nga INSTAT.

Sipas INSTAT, rishikimet rrjedhin nga një përditësim metodologjik, i cili erdhi pas publikimit të CENS të Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri në 2023 (CENS 2023).

Në vitin 2025, INSTAT kalibroi të dhënat për vitet 2023 dhe 2024 duke përdorur popullsinë rezidente respektivisht në datat 1 janar 2023 dhe 1 janar 2024, në vijim të rezultateve të CENS 2023. Më parë, indikatorët llogariteshin duke përdorur popullsinë në 1 janar të vitit përkatës.

Ky kalibrim solli ndryshime në disa nga vlerat e publikuara në vitin 2023, veçanërisht ato që lidhen me indikatorët ekonomikë dhe social për të rinjtë. Si rezultat, disa prej të dhënave për vitin 2023 të publikuara në Raportin e të Rinjve 2023 ndryshojnë nga të dhënat e kalibruara që janë tashmë në dispozicion.

Për të siguruar qartësi dhe transparencë të plotë, ky raport paraqet për krahasim si më poshtë:

***Të Dhëna të Vitit 2023 të Raportuara Fillimisht:** Të dhënat si janë publikuar në Raportin e Monitorimit të Pjesëmarrjes së të Rinjve 2023, bazuar në të dhënat fillestare të ofruara nga INSTAT (para rishikimeve, korrigjimeve dhe kalibrimit).

**** Të Dhëna të Vitit 2023 të Kalibruara:** Të dhënat për vitin 2023 (pas korrigjimeve kur është e aplikueshme) janë kalibruar (rillogaritur) nga INSTAT në vitin 2025, sipas CENS 2023, duke përdorur popullsinë rezidente në 1 janar të vitit përkatës.

***** Të Dhëna të Vitit 2024 (të kalibruara):** Të dhënat për vitin 2024, si janë ofruar nga INSTAT në vitin 2025 në kohën e përgatitjes së këtij raporti, të cilat janë kalibruar bazuar në popullsinë e 1 janar 2024. Nga ky moment e në vazhdim, të gjitha të dhënat do të llogariten duke përdorur Popullsinë Rezidente më 1 janar të vitit përkatës, të kalibruar sipas CENS 2023.

Të dhënat nuk janë kalibruar: Nuk janë raportuar ndryshime për këta indikatorë.

Ky sqarim ofrohet për të ruajtur transparencën metodologjike dhe për t'u lejuar lexuesve të kuptojnë krahasimet ndër vite.



**“Përfaqësimi dhe pjesëmarrja
e të rinjve në role politike
drejtuese dhe vendimmarrëse
ka treguar përparim minimal
gjatë viteve, por mbetet
pothuajse zero.”**



Të Dhëna mbi Pjesëmarrjen Politike të të Rinjve

INDIKATORËT	GJITHSEJ	FEMËR	MASHKULL	VITI
Ministra të Rinj* në Qeveri	0.0%	0.0%	0.0%	2024 ¹
Zëvendësministra të Rinj në Qeveri	0.0%	0.0%	0.0%	2024 ¹
Deputetë të Rinj në Parlament	0.70%	0.70%	0.0%	2024 ¹
Kryebashkiakë të Rinj	0.0%	0.0%	0.0%	2024 ²
Mjete Online për Informim dhe Pjesëmarrje në Vendimmarrje të Qeverisë dhe Parlamentit	94%	Jo e Aplikueshme		2024 ¹
Mjete Online për Informim dhe Pjesëmarrje në Vendimmarrje të Bashkive	97%	Jo e Aplikueshme		2024 ¹
Ekzistenca e Strukturave Rinore (këshillat/parlamentet/bordet) në Nivel Kombëtar	PO	Jo e Aplikueshme		2024 ¹
Ekzistenca e Strukturave Rinore (këshilla/parlamente/bordet) në Nivel Lokal	100%	Jo e Aplikueshme		2024 ¹
% e Buxhetit të Bashkive Dedikuar Rinisë	2 - 3%	Jo e Aplikueshme		2024 ³

*Me të "Rinj" i referohemi grup moshës 15-29 vjeç sipas ligjit për Rininë Nr. 75/2019 në Shqipëri.


[1] Burimi: Hulumtim në zyrë

[2] Burimi: Hulumtim në zyrë dhe Kërkesë zyrtare për Informacion drejtuar Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore

[3] Burimi: Informacion i marrë nëpërmjet Kërkesave zyrtare për Informacion drejtuar 61 Bashkive të Shqipërisë



“Mungesa e të dhënave konsistente dhe të disagreguara për dimensionin social, veçanërisht përsa i përket shkallës së varfërisë dhe të rinjve pjesë e sistemit të mirëqenies sociale, krijon një boshllëk jo vetëm në numra, por edhe në të kuptuarit; pa të dhëna konkrete, situatat, zërat dhe nevojat e të rinjve mbeten të padukshme dhe të paadresuara.”



Të Dhëna mbi Pjesëmarrjen Sociale të të Rinjve

	*Të dhëna të vitit 2023 të raportuara fillimisht			**Të dhëna të vitit 2023 të kalibruara			*** Të dhëna të vitit 2024			
INDIKATORËT	T	F	M	T	F	M	T	F	M	VITI
Të Rinj në Rrezik Varfërie	21.5%	23.4%	19.7%	Të dhënat nuk janë kalibruar			21.9%	23.2%	20.7%	2023 ⁴
Të Rinj në Burgje	39.3%	0.4%	38.9%	Të dhënat nuk janë kalibruar			36.8%	0.4%	36.4%	2024 ⁵
Të Rinj pjesë e Sistemit të Mirëqenies Sociale	19.1%	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Të dhënat nuk janë kalibruar			17.1%	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	2024 ⁶
Braktisja e Shkollës së Mesme	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Të dhënat nuk janë kalibruar			Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	2024 ⁷
Të Rinj të Regjistruar në Arsimin e Lartë	21.3%	25.4%	17.2%	30.7%	36.3%	24.9%	31.4%	37.3%	25.4%	'24-'25 ⁸
Të Rinj të Diplomuar në Arsimin e Lartë	23.6%	26.2%	19.7%	Të dhënat nuk janë kalibruar			23.3%	26%	19.2%	'23-'24 ⁸
Norma e Pjesëmarrjes në Edukim dhe Trajnim Jo-Formal (4 javët e fundit)	0.3%	0.3%	0.3%	Të dhënat nuk janë kalibruar			0.20%	0.20%	0.30%	2024 ⁹
Të Rinj me Arsim të Avancuar	31.6%	42.9%	20.1%	48.2%	67%	30%	46.6%	63.5%	29.5%	2024 ¹⁰
Buxheti dhe Shpenzimet Totale të Qeverisë për Programet e Mbrojtjes Sociale	Buxheti: 30,597,119,000 Lekë Shpenzimet: 30,095,419,629 Lekë			Të dhënat nuk janë kalibruar			Buxheti : 30,620,811,000 Lekë Shpenzimet: 30,332,520,996 Lekë			2024 ¹¹

[4] Burimi: Informacion i marrë nëpërmjet Kërkesës zyrtare për Informacion drejtuar Institutit Kombëtar të Statistikave (INSTAT). Të dhënat për vitin 2023 janë të disponueshme, ndërsa të dhënat për vitin 2024 do të publikohen në dhjetor 2025

[5] Burimi: Informacion i marrë nëpërmjet Kërkesës zyrtare për Informacion drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve

[6] Burimi: Informacion i marrë nëpërmjet Kërkesës zyrtare për Informacion drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimit Social Shtetëror

[7] Burimi: Informacion i marrë nëpërmjet Kërkesës për Informacion drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit

[8] Burimi: Informacion i marrë nëpërmjet Kërkesës zyrtare për Informacion drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Institutit Kombëtar të Statistikave (INSTAT)

[9] Burimi: Informacion i marrë nëpërmjet Kërkesës zyrtare për Informacion drejtuar Institutit Kombëtar të Statistikave (INSTAT)

[10] Burimi: Hulumtim në zyrë bazuar në të dhënat nga Databaza e INSTAT

[11] Burimi: Informacion i marrë nëpërmjet Kërkesës zyrtare për Informacion drejtuar Shërbimit Social Shtetëror



**“Pabarazitë gjinore në
pjesëmarrjen ekonomike të të
rinjve mbeten të dukshme.
Vajzat vazhdojnë të përballen
me vështirësi, dhe nuk kanë
ende mundësi të barabarta
për punësim, sipërmarrje dhe
pavarësi financiare.”**



Të Dhëna mbi Pjesëmarrjen Ekonomike të të Rinjve

	*Të dhëna të vitit 2023 të raportuara fillimisht			**Të dhëna të vitit 2023 të kalibruara			*** Të dhëna të vitit 2024			
INDIKATORËT	T	F	M	T	F	M	T	F	M	YEAR
Shkalla NEET (Të Rinj jo në Punësim, Arsim, apo Trajnim	24.6%	25.6%	23.5%	25.0%	27.8%	22.3%	22.2%	24.7%	19.7%	¹² 2024
Shkalla e Papunësisë e të Rinjve	22.2%	20.6%	23.6%	21.7%	21.9%	21.6%	18.9%	19.0%	18.8%	¹² 2024
Shkalla e Papunësisë Afatgjatë e të Rinjve	15.0%	12.5%	17.2%	14.3%	13.3%	15.2%	12.8%	13.2%	12.4%	¹² 2024
Shkalla e Pjesëmarrjes në Forcën Punës e të Rinjve	56.9%	52.0%	61.8%	53.5%	48.1%	58.7%	54.8%	48.9%	60.6%	¹² 2024
Shkalla e Punësimit të të Rinjve	44.2%	41.3%	47.2%	41.9%	37.6%	46.0%	44.4%	39.6%	49.2%	¹² 2024
Përqindja e të Rinjve që themeluan Biznesin e tyre me Mbështetjen Financiare të Shtetit	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	¹³ 2024
Të Rinj të Vetëpunësuar	15.1%	12.5%	17.5%	13.9%	10.9%	16.3%	13.8%	8.5%	18.0%	¹² 2024
Buxheti dhe Shpenzimet Totale të Qeverisë në Programet Nxitjes së Punësimit	Shpenzimet: 626,790,431 Lekë			Të dhënat nuk janë kalibruar			Buxheti: 432,000,000 Lekë Shpenzimet: 411,000,000 Lekë			¹⁵ 2024

SHËNIME SQARUESE:

***Të dhëna të vitit 2023 të raportuara fillimisht:** Të dhënat e publikuara në Raportin e Monitorimit të Pjesëmarrjes së të Rinjve 2023, bazuar në informacionin e ofruar fillimisht nga Instituti Kombëtar i Statistikave (INSTAT).

**** Të dhëna të vitit 2023 të kalibruara:** Të dhënat për vitet 2023 dhe 2024 janë kalibruar sipas CENS 2023 (Popullsisë Rezidente të 1 janar të vitit përkatës). Më parë, llogaritjet bazoheshin në Popullsinë të 1 janar të vitit përkatës. Nga tani e në vazhdim, të gjitha të dhënat do të llogariten duke përdorur Popullsinë Rezidente të 1 janar të çdo viti përkatës.

[12] Burimi: Informacion i marrë nëpërmjet Kërkesës zyrtare për Informacion drejtuar Institutit Kombëtar të Statistikave (INSTAT)
[13] Burimi: Informacion i marrë nëpërmjet Kërkesës zyrtare për Informacion drejtuar Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit
[14] Burimi: Informacion i marrë nëpërmjet Kërkesës zyrtare për Informacion drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve
[15] Burimi: Informacion i marrë nëpërmjet Kërkesës zyrtare për Informacion drejtuar Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive



ANALIZA DHE KRAHASIMI I TË DHËNAVE GJATË 9 VITEVE TË MONITORIMIT

Në përgjithësi, disa indikatorë kanë ndryshuar si pozitivisht dhe negativisht ndër vite. Megjithatë, krahasuar me të dhënat e prezantuara në raportin e parë, nëntë vjet më parë, vërehet një përmirësim i dukshëm.

Dimensioni i Pjesëmarrjes Politike

Pjesëmarrja politike e të rinjve në Shqipëri vazhdon të jetë shumë e ulët, pa asnjë të ri/të re që mban pozicione politike drejtuese, si ministër, zëvendësministër ose kryetar bashkie. Edhe pse, ekzistojnë struktura rinore si në nivel kombëtar dhe lokal, dhe prania e mjeteve digjitale për informim është rritur, duke u mundësuar të rinjve qasje në informacion dhe pjesëmarrje në vendimmarrje, përfaqësimi domethënës i të rinjve në udhëheqjen politike vazhdon të mungojë.

Përfaqësimi i të rinjve në pozicionet si ministër në Shqipëri mungon plotësisht, pa asnjë emërim të të rinjve nën 30 vjeç si ministër gjatë periudhës 2016 - 2024. Në vitin 2024, vetëm dy ministra janë nën moshën 40 vjeç, ndërsa mosha mesatare e kabinetit është 43.7 vjeç, duke nxjerrë në pah hendekun e vazhdueshëm midis udhëheqjes së qeverisë dhe brezit të ri (15–29 vjeç). Edhe pse gratë përbëjnë një numër të konsiderueshëm të ministrave (52.9%), prania e tyre ka rënë ndjeshëm vitet e fundit, nga 81% në vitin 2022 në 52.9% në vitin 2024, duke shënuar një rënie të dukshme prej 28%, dhe një kthim pas në barazinë gjinore brenda qeverisë.

Gjithashtu, në vitin 2024, në Shqipëri nuk kishte asnjë zëvendësministër të ri. Historikisht, prania e të rinjve në këto pozicione ka qenë minimale dhe në dy vitet e fundit ka rënë në zero. Mosha mesatare e zëvendësministrave është 43.2 vjeç, me një ulje të lehtë prej 4% krahasuar me një vit më parë. Burrat dominojnë këto role (56%), ndërsa përqindja e grave ka rënë me 10% gjatë dy viteve të fundit, duke reflektuar një trend të uljes së përfaqësimit të grave në pozicione drejtuese si zëvendësministre.

Përfaqësimi i të rinjve si deputet në Parlamentin e Shqipërisë ka qenë vazhdimisht i ulët ndër vite, me një rënie të ndjeshme në katër vitet e fundit. Në vitin 2024, përfaqësimi i të rinjve në parlament arriti nivelin më të ulët, me vetëm një të re si deputete. Parlamenti mbetet i dominuar nga burrat, të cilët përbëjnë 64% të deputetëve, ndërsa gratë përbëjnë vetëm 36%. Mosha mesatare e deputetëve është 51.5 vjeç, duke reflektuar një strukturë ligjvënese që është kryesisht e vjetër dhe me shumë pak përfaqësues të brezave të rinj.

Në nivel lokal, Shqipëria vazhdon të mos ketë asnjë kryetar bashkie të ri/të re, një trend që ka vazhduar gjatë gjashtë viteve të fundit. Lidershipi lokal karakterizohet nga një pabarazi e theksuar gjinore, ku burrat përbëjnë shumicën dhe gratë përfaqësojnë vetëm 13%. Mosha mesatare e kryetarëve të bashkive është 47 vjeç, dhe më pak se një në pesë (18%) janë nën moshën 40 vjeç, duke nxjerrë në pah një përbërjet të udhëheqjes lokale të bazuar në eksperiencë dhe në proporcion të drejtë me moshën.

Disponueshmëria e mjeteve online për ndarjen e informacionit dhe pjesëmarrjen publike në vendimmarrje brenda qeverisë dhe parlamentit është rritur vazhdimisht me kalimin e viteve, duke arritur në 94% në vitin 2024. Shumica e institucioneve tani kanë platforma digjitale të dedikuara (faqe web, dhe rrjete sociale si facebook, instagram) për të komunikuar dhe për të informuar publikun mbi punën e tyre. Vetëm një Ministër Shteti aktualisht nuk përdor asnjë formë të mjeteve të komunikimit online.

Një trend i ngjashëm paraqitet edhe në nivel bashkie, ku 97% e bashkive kanë mjete të tilla. Megjithatë vërehet se komunikimi kryhet kryesisht përmes llogarive personale të kryetarëve të bashkive, në vend të faqeve zyrtare online të bashkive apo rrjeteve të tyre sociale. Në shumë raste, janë vetë kryetarët e bashkive, që përmes platformave sociale personale ndajnë përditësime dhe zhvillime në lidhje me punën e tyre në qytet.

Pavarësisht pranisë së mjeteve digjitale për informin, takimet dhe diskutimet me të rinjtë zbulojnë një mungesë të konsiderueshme informacioni. Shumë prej të rinjve mbeten të painformuar dhe nuk kanë njohuri rreth aktiviteteve dhe zhvillimeve kryesore, si në përgjithësi ashtu edhe në mënyrë specifike në lidhje me çështjet rinore, si në nivel lokal ashtu edhe në atë kombëtar. Zakonisht, vetëm një grup i vogël të rinjsh shumë aktivë ose veçanërisht të interesuar janë të mirë informuar dhe marrin pjesë vazhdimisht në aktivitete.

Në nivel kombëtar, strukturat rinore, si Këshilli Kombëtar Rinor, Kongresi Rinor Kombëtar dhe Agjencia Kombëtare e Rinisë, ekzistojnë prej disa vitesh, dhe luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen dhe angazhimin e të rinjve. Agjencia Kombëtare e Rinisë vepron në koordinim me Ministrin e Shtetit për të Rinjtë dhe Fëmijët dhe është veçanërisht aktive në promovimin e pjesëmarrjes, zhvillimit dhe fuqizimit të të rinjve, duke bashkëpunuar ngushtë me institucione të tjera për të siguruar përfshirjen e të rinjve në politika dhe vendimmarrje.

Në nivel lokal, strukturat rinore janë ngritur në të gjitha qytetet e Shqipërisë, kryesisht në formën e Këshillave Vendor Rinor (KVR), të cilat u ngritën plotësisht në të gjithë vendin deri në janar të vitit 2024. KVR-të kanë në fokus të punës së tyre angazhimin e të rinjve në nivel lokal, lehtësimin e pjesëmarrjes në vendimmarrje, organizimin e aktiviteteve dhe shpërndarjen e informacionit. Ndërsa shumica e KVR-ve janë aktive, disa mbeten funksionale vetëm pjesërisht, duke mos arritur zbatimin e plotë të detyrave të tyre, si dhe duke kufizuar kështu përfaqësimin dhe angazhimin e të rinjve. Efektiviteti i tyre në përmbushjen e roleve të synuara shpesh kufizohet nga mungesa e burimeve, kapaciteteve apo dhe përparësisë nga autoritetet lokale.

Për të arritur plotësisht potencialin e tyre, nevojitet një angazhim më i madh dhe më i qëndrueshëm për t'i pajisur këto këshilla me mjetet, mbështetjen dhe autonominë e nevojshme për të funksionuar si agentë aktivë të fuqizimit të të rinjve dhe pjesëmarrjes qytetare. Pa përpjekje të tilla, këto struktura rrezikojnë të bëhen më shumë simbolike sesa transformuese.

Struktura të tjera rinore në nivel lokal, si qendrat rinore, hapësirat multifunksionale, qendrat kulturore dhe sportive, si dhe shkollat ose qendrat komunitare, ekzistojnë në disa bashki, por jo në çdo qytet. Kjo shpërndarje e pabarabartë rezulton në mundësi të pabarabarta për të rinjtë në të gjithë vendin, pasi qasja në këto shërbime dhe mundësitë për zhvillim personal varen nga vendndodhja gjeografike, zona ose qyteti në të cilin të rinjtë jetojnë.

Dimensioni i Pjesëmarrjes Sociale

Dimensioni social i pjesëmarrjes së të rinjve në Shqipëri mbetet një nga më shqetësuesit, veçanërisht për shkak të mungesës së theksuar të të dhënave gjithëpërfshirëse, të disagreguara dhe specifike për rininë. Të dhënat në dipozicion mbi indikatorët e dimensionit social janë të fragmentuara dhe shpesh nuk janë të ndara sipas gjinisë ose grupmoshës së të rinjve (15-29). Këto mungesa krijojnë hapësira në kuptimin e realiteteve të të rinjve dhe e bëjnë të pamundur krahasimin e nevojave të grupeve të ndryshme.

Edhe pse “Ligji për Rininë” i përcakton qartë të rinjtë si individë të moshës 15-29 vjeç, shumë institucione ende nuk mbledhin, përpunojnë dhe raportojnë të dhëna sipas kësaj grupmoshe. Kjo mungesë e vazhdueshme e të dhënave përbën një sfidë të rëndësishme në Shqipëri.

Mungesa e informacionit të besueshëm, veçanërisht mbi grupet vulnerabël siç janë të rinjtë të varfër, përfituesit e skemave të mirëqenies sociale ose ata me vulnerabilitete të ndërthurura, mund të jetë një nga pengesat kryesore për zhvillimin e politikave efektive.

Pavarësisht përpjekjeve të përsëritura ndër vite, duke përfshirë kërkesat zyrtare për informacion dhe advokim për rritjen e ndërgjegjësimit në këtë drejtim, institucionet kanë bërë shumë pak përparim në krijimin e praktikave sistematike për mbledhjen e të dhënave specifike për rininë.

Mungesa e këtyre të dhënave kufizon aftësinë për të kuptuar plotësisht problematikat dhe nevojat e të rinjve, pengon hartimin e politikave të bazuara në të dhëna, kufizon monitorimin efektiv të programeve dhe dobëson aftësinë e shtetit për të hartuar ndërhyrje që adresojnë në mënyrë adekuate vështirësitë/problematikat e të rinjve, reduktojnë varfërinë e të rinjve dhe nxisin përfshirjen e tyre.

21.9% e të rinjve në Shqipëri në vitin 2023 ishin në rrezik varfërie. Edhe pse kjo e dhënë tregon një ulje të përgjithshme prej 3.8% nga viti 2017 në vitin 2023, progresi mbetet i ulët dhe me luhatje. Në vitin 2023 vihet re një rritje e lehtë prej 0.4% krahasuar me vitin 2022.

Ulja në përqindjen e rrezikut për të qenë i varfër midis të rinjve gjatë periudhës 2017-2023 ka qenë e pabarabartë midis gjinive. Djemtë kanë pasur një ulje më të madhe (-6.2%) krahasuar me vajzat (-1.1%). Pabarazia gjinore mbetet e theksuar, me vajzat (23.2%) që janë në rrezik më të lartë varfërie, krahasuar me 20.7% të djemve. Kjo tregon vulnerabilitet sistematik gjinor, duke reflektuar pabarazi të mëdha në aksesin në burime, mundësi punësimi dhe mbrojtje sociale.

Këto gjetje nxjerrin në pah se, edhe pse përqindjet e përgjithshme të rrezikut për të qenë i varfër midis të rinjve janë përmirësuar, pabarazitë gjinore mbeten të theksuara, duke treguar nevojën për ndërmarrjen e masave të targetuara. Adresimi efektiv i rrezikut të varfërisë tek të rinjtë kërkon jo vetëm masa të gjera për punësim dhe përfshirjeje sociale, por edhe politika të synuara dhe të përgjegjshme ndaj gjinisë, të cilat zvogëlojnë barrierat për vajzat dhe sigurojnë akses të barabartë në mundësitë ekonomike dhe mbrojtjen sociale.

Gjatë nëntë viteve të fundit, të rinjtë kanë përfaqësuar vazhdimisht një përqindje të lartë të popullsisë së burgjeve në Shqipëri.

Në vitin 2024, të rinjtë përbëjnë 36.8% të burgosurve të trajtuar në Institucionet e Ekzekutimeve të Vendimeve Penale, ku djemtë përbëjnë pothuajse të gjithë këtë përqindje (36.4%), krahasuar me vetëm 0.4% për vajzat. Ky dallim i theksuar gjinor nënvizon ekspozimin më të lartë të djemve ndaj aktiviteteve që çojnë në burgosje.

Vlen të përmendet se në vitin 2024 u regjistrua një ulje prej 2.5% të përqindjes së të rinjve në burgje krahasuar me vitin 2023, duke shënuar rënien e parë pas katër viteve radhazi rritjeje. Kjo rënie vjen tërësisht prej reduktimit të përqindjes së djemve të burgosur, ndërsa përqindja e vajzave mbeti e pandryshuar.

Të dhënat tregojnë se të rinjtë përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të përfituesve brenda sistemit të mirëqenies sociale në Shqipëri. Megjithatë, mungon një pasqyrë e plotë sepse nga tre programet kryesore të ndihmës sociale, informacioni i grupuar sipas moshës është i disponueshëm vetëm për përfituesit e ndihmës ekonomike, ndërsa për programet e tjera nuk ka të dhëna për grupmoshën 15-29 vjeç.

Ky boshllëk në të dhënat specifike për të rinjtë, veçanërisht të disagreguara sipas moshës, gjinisë, etnitetit dhe statusit të vulnerabilitetit, për programet e mirëqenies sociale (përtej ndihmës ekonomike), pengon një kuptim të plotë të mënyrës se si sistemi i mirëqenies adreson nevojat e të rinjve përmes formave të ndryshme të mbështetjes, kufizon monitorimin dhe vlerësimin efektiv dhe kufizon kapacitetin për zhvillimin e politikave të bazuara në të dhëna për të trajtuar varfërinë e të rinjve dhe për të nxitur përfshirjen sociale.

Në vitin 2024, 17.1% e përfituesve të ndihmës ekonomike ishin të rinj të moshës 18-30 vjeç, duke shënuar një ulje prej 2% nga 19.1% në vitin 2023. Ndërsa kjo rënie mund të reflektojë përmirësime modeste në situatën socioekonomike të disa të rinjve, ajo gjithashtu mund të tregojë vështirësi në aksesin në mbështetje, qoftë për shkak të kërkesave të shumta të pranimi apo barrierave administrative. Nevojitet një analizë më e thelluar për të përcaktuar arsyet kryesore të këtij trendi.

Në përgjithësi, ndërsa shifrat ekzistuese nënvizojnë rëndësinë e ndihmës ekonomike për një numër të konsiderueshëm të të rinjve, ato gjithashtu theksojnë nevojën urgjente për praktika të përmirësuara dhe të standardizuara të mbledhjes dhe raportimit të të dhënave. Forcimi i politikbërjes bazuar në të dhëna, veçanërisht përmes mbledhjes sistematike të të dhënave të ndara sipas moshës, gjinisë, etnisë dhe statusit të vulnerabilitetit është thelbësor për hartimin e politikave sociale që i përgjigjen të rinjve dhe për të siguruar që asnjë segment i popullsisë së re të mos anashkalohet.

Të dhënat tregojnë një trend pozitiv në pjesëmarrjen e të rinjve në arsimin e lartë, shoqëruar me një pabarazi të konsiderueshme gjinore që kërkon vëmendje të mëtejshme. Në vitin 2024, 31.4% e të rinjve të moshës 18-29 vjeç ishin të regjistruar në arsimin e lartë, duke shënuar një rritje modeste prej 0.7% krahasuar me vitin 2023 (30.7%). Ky trend në rritje sugjeron një kërkesë në rritje për arsim të lartë midis të rinjve, që është një tregues pozitiv për zhvillimin e kapitalit njerëzor të vendit.

Megjithatë, modelet gjinore zbulojnë një hendek në zgjerim: shkalla e regjistrimit të vajzave të reja është 11.9% më e lartë se ajo e djemve. Dhe në vitin 2024 rritja e përqindjes së regjistrimit ishte më e lartë tek vajzat (+1%) sesa tek djemtë (+0.5%).

Kjo pasqyron një model të qëndrueshëm të vërejtur vitet e fundit, ku vajzat demonstrojnë një angazhim më të madh në arsim, veçanërisht në arsimin e lartë.

Ndërsa pjesëmarrja e lartë e vajzave është inkurajuese, zgjerimi i hendekut gjinor ngre pyetje mbi faktorët që mund të kontribuojnë në regjistrimin më të ulët të djemve. Shpjegime të mundshme përfshijnë hyrjen më të hershme në tregun e punës, shkallë më të lartë të emigracionit ose një preferencë për rrugë arsimore profesionale jashtë sistemit universitar. Kuptimi i këtyre dinamikave është i rëndësishëm për të siguruar një pjesëmarrje të ekuilibruar, dhe për të hartuar politika që adresojnë barrierat me të cilat përballen djemtë, duke vazhduar njëkohësisht të mbështesin angazhimin e lartë arsimor të vajzave.

Në vitin 2024, përqindja e diplomimit të të rinjve të moshës 18-29 vjeç ishte 23.3%, duke vazhduar një trajektore uljeje trevjeçare. Krahësuar me vitin 2023, u shënua një ulje prej 0.3%, me rënie më të theksuar tek djemtë (-0.5%). Edhe këtu, pabarazitë gjinore mbeten të konsiderueshme. Përqindja e diplomimit të djemve është 6.8% më e ulët se ajo e vajzave, duke konfirmuar një model të qëndrueshëm ku vajzat kanë performancë më të mirë se djemtë në arsimin e lartë.

Përqindja më e lartë e diplomimeve u regjistrua në vitin 2019, pas së cilës është vërejtur një rënie e vazhdueshme. Ky trend negativ ngre shqetësime në lidhje me pengesat e mundshme që i pengojnë të rinjtë, veçanërisht djemtë të përfundojnë arsimin e lartë. Edhe këtu shpjegime të mundshme përfshijnë presionet ekonomike që çojnë në hyrje të hershme në tregun e punës, emigracion të shtuar ose sfidat brenda sistemit arsimor, si progresi akademik, cilësia e programeve, ose mungesa e shërbimeve mbështetëse.

46.6% e të rinjve të moshës 25-29 vjeç kanë përfunduar arsim të nivelit të lartë (diplomë të lartë, master, doktoraturë, etj.) në vitin 2024. Kjo tregon një rënie prej 1.6% krahasuar me vitin 2023 (48.2%), dhe një ulje të lehtë të përqindjes së të rinjve me arsim të lartë brenda kësaj grupmoshe. Ndarja sipas gjinisë zbulon pabarazi të konsiderueshme. 63,5% e vajzave kanë arsim të avancuar, krahasuar me vetëm 29,5% të djemve. Edhe pse të dy grupet patën rënie të lehta krahasuar me vitin 2023 (-3,5% për vajzat dhe -0,5% për djemtë), hendeku mbetet i madh, me vajzat që vazhdojnë t'i tejkalojnë djemtë me 34%.



Dimensioni i Pjesëmarrjes Ekonomike

Gjatë viteve 2016 -2024, të dhënat tregojnë një rënie të vazhdueshme të shkallës NEET (Të rinj jo në Arsim, Punësim ose Trajnim) të të rinjve në Shqipëri. Pavarësisht luhatjeve, veçanërisht rritjes së dukshme në vitin 2020 për shkak të pandemisë COVID-19, tendenca e përgjithshme pasqyron progres të vazhdueshëm në angazhimin e të rinjve në arsim dhe në tregun e punës. Megjithatë, vazhdon të ketë pabarazi të konsiderueshme gjinore dhe nivelet e përgjithshme janë ende të larta krahasuar me mesataren e Bashkimit Evropian (BE) (11%).

Hendeku gjinor mbetet i dukshëm, me vajzat që përballen me nivele më të larta përjashtimi nga arsimi, trajnimi dhe punësimi, **5% më shumë se djemtë**. Edhe pse hendeku po ngushtohet me kalimin e kohës, nga 8.8% në vitin 2017 në 5% në vitin 2024, vajzat vazhdojnë të kenë përqindje relativisht më të larta NEET, duke theksuar nevojën për masa të synuara dhe sisteme mbështetëse me ndjeshmëri gjinore për të adresuar barrierat dhe për të promovuar përfshirje më të madhe të vajzave si në tregun e punës ashtu edhe në sistemin arsimor.

Shkalla NEET ndryshon ndjeshëm në varësi të nivelit të arsimit të përfunduar. Analiza e shkallës NEET sipas nivelit të arsimit ndër vite tregon se nga **viti 2016 deri në vitin 2022**, shkalla NEET ishte vazhdimisht më e lartë tek të rinjtë me **arsim të mesëm**, e ndjekur nga ata me **arsim të lartë**, një model mjaft i pazakontë krahasuar me pritshmëritë. Megjithatë, ky trend ka ndryshuar në dy vitet e fundit, me shkallë më të lartë të NEET të regjistruara tani tek të rinjtë me **arsim të mesëm (24.6% në vitin 2024)** dhe ata me **vetëm arsim të ulët (22.3% në vitin 2024)**, ndërsa nivelet më të ulëta vërehen tek **të diplomuarit në arsim të lartë (18.4% në vitin 2024)**.

Vajzat përballen vazhdimisht me norma më të larta NEET në të gjitha nivelet e arsimit, duke treguar pabarazi sistematike gjinore. Veçanërisht, vajzat me arsim të mesëm mbeten grupi më i prekur (**29.3% krahasuar me 21% për djemtë në vitin 2024**).

Gjetjet më sipër theksojnë se arsimi më i lartë nuk garanton domosdoshmërisht mbrojtje nga inaktiviteti ekonomik, veçanërisht e vërtetë për vajzat, dhe nënvizojnë nevojën për politika dhe masa mbështetëse më të forta për të lehtësuar tranzicionin nga arsimi drejt tregut të punës.




Figura 1: Shkalla Neet sipas nivelit të arsimit

Ulja e shkallës NEET, veçanërisht rënia e ndjeshme midis viteve 2022 (25.2%) dhe 2024 (22.2%), mund të pasqyrojë efektet pozitive të politikave të synuara dhe iniciativave për punësimin e të rinjve, duke përfshirë zbatimin e Garancisë Rinore (YG) dhe përpjekjet e shtuara për të promovuar arsimin profesional dhe sistemin e ri të arsimit profesional të dyfishtë (arsimi dual).

Zbatimi i Garancisë Rinore në Shqipëri filloi në vitin 2023 dhe parashikon që çdo të riu të regjistruar në skemë duhet t'i ofrohet një ofertë pune, trajnim ose mundësi arsimimi profesional brenda katër muajve nga regjistrimi. Deri në vitin 2024, programi ishte në fazën pilote, i zbatuar në tre bashki kryesore: Tiranë, Shkodër dhe Vlorë. Në vitin 2025, skema do të zgjerojë zbatimin e saj nga nivel bashkie në nivel rajoni.

Gjatë fazës pilot të Garancisë Rinore, 21 nëntor 2023 deri më 31 dhjetor 2024, janë regjistruar në Skemën e Garancisë Rinore **560 të rinj NEET**. Shpërndarja nëpër bashki është si më poshtë: 271 të rinj në Bashkinë Tiranë, 210 në Bashkinë Shkodër dhe 79 në Bashkinë Vlorë.




Figura 2: shpërndarja gjeografike e të rinjve NEET në 3 qytetet, në të cilat është pilotuar Garancia Rinore

Nga numri i përgjithshëm i të rinjve të regjistruar në skemë, 74% e tyre (414 NEET) u integruan në tregun e punës nëpërmjet një daljeje pozitive nga skema.




Figura 3: Neet të identifikuar si pjesë e garancisë rinore dhe pjesa e tyre e integruar përmes shërbimeve të saj

Më konkretisht:

- 242 të rinj u punësuan nëpërmjet shërbimeve të ndërmjetësimit në punë, nga të cilët 130 u përfshinë në Programet e Nxjitjes së Punësimit.
- 27 të rinj u angazhuan përmes ofertës arsimore, përfshirë këtu integrimin përmes Programit të Kodimit.
- 145 të rinj përfituan nga ofertat e trajnimit, duke përfshirë këtu integrimin në kurse afatshkurtra, si dhe në programe për rritjen e aftësive profesionale, përmes programit të praktikave profesionale të mbështetura nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA).




Figura 4: shërbimet e ofruara për NEET të integruar nëpërmjet zbatimit të Garancisë Rinore

Shkalla e papunësisë e të rinjve në Shqipëri, pavarësisht një rritje minimale në vitin 2023, rifilloi trajektoren e saj në rënie në vitin 2024, duke arritur nivelin më të ulët në pothuajse një dekadë (18.9%). Midis viteve 2016 dhe 2024, shkalla e papunësisë është ulur vazhdimisht nga 29.8% në 18.9%, duke shënuar një përmirësim të konsiderueshëm prej gati 11%. **Megjithatë, pavarësisht këtij progresi, papunësia e të rinjve në Shqipëri mbetet dukshëm më e lartë se mesatarja e BE-së prej 5.9%.** Është inkurajuese që hendeuku gjinor pothuajse është mbyllur, me vajzat (19%) dhe djemtë (18.8%) që regjistruan nivele pothuajse të njëjta në vitin 2024.

Pas rritjes së vazhdueshme për tre vitet e mëparshme në shkallën e papunësisë afatgjatë, në vitin 2024 ajo u ul me **1.6 %**, duke arritur në **12.8%**. Rënia ishte më e lartë tek djemtë, shkalla e të cilëve ra me **2.8%**, ndërsa shkalla e vajzave mbeti pothuajse e pandryshuar, duke rënë vetëm me **0.1%**.

Historikisht, djemtë kanë përjetuar papunësi afatgjatë më të lartë se vajzat, por në vitin 2024 ky trend u përmbys, për herë të parë në gjashtë vitet e fundit, papunësia afatgjatë e vajzave (**13.2%**) e tejkaloi atë të djemve (**12.4%**). Kjo vjen pas rritjes graduale të papunësisë afatgjatë të vajzave ndër vite nga viti 2019 (**8.9%**) deri në vitin 2023 (**13.3%**).

Pjesëmarrja e të rinjve në forcën punëtore në Shqipëri ka treguar një trajektore pozitive në rritjeje (9.1%), duke u rritur nga 45.7% në vitin 2016 në 54.8% në vitin 2024, duke reflektuar një lidhje më të fortë të të rinjve me tregun e punës.

Nëse kjo tendencë vazhdon, Shqipëria mund të arrijë një shkallë pjesëmarrjeje të të rinjve në forcën e punës rreth 60% deri në vitin 2030, duke ngushtuar hendekun me shkallën pjesëmarrjes së popullsisë së përgjithshme në forcën e punës. Megjithatë, për ta mbështetur këtë rritje ka nevojë për zgjerim të vazhdueshëm ekonomik dhe trajnime të aftësive.

Përmirësimi në pjesëmarrjen e të rinjve në forcën e punës ka qenë i qëndrueshëm, me vetëm një rënie të vogël të lidhur me pandeminë në vitin 2020, e ndjekur nga një rimëkëmbje e shpejtë drejt një kulmi prej 55.5% në vitin 2022. Megjithatë, vazhdon të mbetet shqetësues hendeku i vazhdueshëm dhe i konsiderueshëm gjinor, me pjesëmarrjen e djemve që vazhdimisht e tejkalon pjesëmarrjen e vajzave me një mesatare prej afërsisht 12%. Ndërsa ky hendek mbetet i konsiderueshëm, një trend premtues po shfaqet me kalimin e viteve: rritja e pjesëmarrjes së vajzave (3.3%) vitet e fundit ka tejkaluar rritjen në pjesëmarrjen e djemve (1.4%), duke sugjeruar një ngushtim të mundshëm, megjithëse gradual, të hendekut gjinor.

Të dhënat tregojnë një trend pozitiv të shkallës së punësimit të të rinjve në Shqipëri ndër vite, duke treguar një përmirësim të ndjeshëm të suksesit të të rinjve në gjetjen e mundësive të punësimit. Shkalla e punësimit e të rinjve në Shqipëri ka ndjekur përgjithësisht një trend rritës, pavarësisht rënies në vitin 2023, rënia e parë në vitet e fundit. Në vitin 2024, shkalla e punësimit u rrit në 44.4%, duke shënuar një rritje prej 2.5% krahasuar me vitin 2023 (41.9%). Kjo rritje është më e theksuar për djemtë (3.2%) sesa për vajzat (2%).

Si gjithmonë, shkalla e punësimit e vajzave mbetet më e ulët se ajo e djemve. Në vitin 2024, punësimi i vajzave ishte 39.6%, 9.6% më e ulët se ai i djemve (49.2%). Edhe pse punësimi i vajzave është rritur gradualisht midis viteve 2016 dhe 2024, hendeku gjinor mbetet i lartë dhe tregon pak shenja përmirësimi.

Një nga praktikatat e mira që po zbatohet në Shqipëri është Programi Kombëtar i Praktikave të Punës, për të cilin hapen thirrje për aplikime, duke ftuar të rinjtë e interesuar të aplikojnë për mundësi pune praktike në institucionet shtetërore. Programi u ofron pjesëmarrësve eksperiencë praktike të drejtpërdrejtë në administratën publike, duke u ofruar atyre si aftësi praktike ashtu edhe një ekspozim të vlefshëm ndaj funksionimit të strukturave shtetërore.

Vetëm 13.8% e të rinjve të punësuar në Shqipëri janë të vetëpunësuar. Ndër vite, përqindja e të rinjve të vetëpunësuar ka qenë vazhdimisht në rënie, me një ulje prej 7.9% midis viteve 2018 (21.7%) dhe 2024 (13.8%). Kjo tregon një ndryshim në tregun e punës ku punësimi nxitet gjithnjë e më shumë nga puna me pagë sesa nga sipërmarrja.

Shumë pak vajza (8.5%) zgjedhin vetëpunësimin si një mundësi, krahasuar me djemtë (18%), pothuajse dyfish më shumë. Një zhvillim veçanërisht shqetësues u vu re në vitin 2024, **një rënie e ndjeshme e vetëpunësimit të vajzave, duke e zgjeruar akoma më tej këtë hendek, në nivelin më të lartë të regjistruar (9.5%).**

Kjo divergjencë në rritje nënvizon praninë e barrierave të konsiderueshme dhe në rritje për vajzat sipërmarrëse, duke sinjalizuar nevojën urgjente për masa të synuara politike për të nxitur pjesëmarrjen e barabartë ekonomike.

4.3% e të rinjve të moshës 15-17 vjeç janë zyrtarisht të punësuar. Shumica e tyre, 2.9%, janë djem, ndërsa vetëm 1.4% janë vajza. Këto të dhëna reflektojnë një trend ku djemtë prezantohen me mundësitë dhe inkurajohen të angazhohen në aktivitet ekonomik që në moshë të re, më shumë, sesa vajzat. Krahësuar me vitin 2023 (4.1%), shkalla e përgjithshme e punësimit të të rinjve(15-17 vjeç) shënoi një rritje të vogël prej 0.2% (4.3% në vitin 2024). Kjo rritje e lehtë i atribuohet tërësisht një rritjeje të punësimit të vajzave, duke treguar shenjat e para të përmirësimit në përfshirjes së tyre ekonomike që në moshë të hershme.

45.2% e të rinjve në Shqipëri në vitin 2024 janë inaktivë, që do të thotë se nuk janë as të punësuar dhe as në kërkim aktiv të punës. Ky grup përfshin studentë, persona me aftësi të kufizuara, të rinj të angazhuar në punët e shtëpisë dhe të rinj të dekurajuar që kanë ndaluar së kërkuari punë. Ndërsa ka pasur një përmirësim të dukshëm të përgjithshëm në shkallën totale të inaktivitetit të të rinjve në Shqipëri, e cila ka rënë nga 49.9% në vitin 2018 në 45.2% në vitin 2024, progresi ka qenë i paqëndrueshëm me luhatje të konsiderueshme.

Pabarazia gjinore e vazhdueshme mbetet më shqetësuese. Gjatë gjithë këtyre viteve, vajzat kanë pasur vazhdimisht përqindje inaktiviteti shumë më të larta se djemtë, me një hendek mesatar prej afërsisht 12%. Në vitin 2024, shkalla e inaktivitetit tek vajzat ishte 51.1% krahasuar me 39.4% për djemtë, duke treguar se shumë vajza nuk janë të përfshira në tregun e punës.

Një total prej 17,215 të rinjsh, që përfaqësojnë rreth 4% të popullsisë së moshës 15-29 vjeç në Shqipëri, kërkojnë në mënyrë aktive punë dhe aktualisht janë të papunë. Ky numër është rritur vazhdimisht gjatë dy viteve të fundit, me një rritje prej rreth 3800 të rinjsh midis viteve 2022 dhe 2024, duke reflektuar sfidat e vazhdueshme në integrimin e të rinjve në tregun e punës.





REKOMANDIME

Ky sesion synon të ofrojë rekomandime për politika, iniciativa dhe strategji për aktorët e interesuar (organizatat rinore, institucionet publike në nivel lokal dhe kombëtar), që të adresojnë dhe të advokojnë në mënyrë efektive për ndryshime pozitive të politikave në fushën e rinisë.

Rekomandime për pjesëmarrjen politike të të rinjve

Dimensioni i pjesëmarrjes politike të të rinjve në Shqipëri ka shënuar progresin më të vogël, me indikatorë që tregojnë përmirësim minimal ndër vite. Të rinjtë vazhdojnë të jenë dukshëm të nën përfaqësuar në rolet kryesore politike, si ministra, zëvendësministra, deputetë dhe kryetarë bashkie. Kjo mungesë e vazhdueshme e përfaqësimit të të rinjve nxjerr në pah barriera të sistemit që kufizojnë aksesin e tyre në pozicione drejtuese dhe vendimmarrëse. Nën përfaqësimi i tyre në politikë jo vetëm që dobëson zërin e tyre në qeverisje, por gjithashtu kufizon integrimin e perspektivave të reja dhe zgjidhjeve inovative në proceset e politikëbërjes. Nëse nuk merren masa, një brez i tërë mund të plakët pa pasur kurrë një zë në qeverisje, duke thelluar kështu zhgënjimin e tyre ndaj proceseve demokratike.

Për të adresuar mungesën pothuajse të plotë të të rinjve në jetën politike të Shqipërisë, nevojitet një përqasje gjithëpërfshirëse që kombinon reforma strukturore, ndërtimin e kapaciteteve dhe ndërgjegjësimin e hershëm. Rekomandimet e mëposhtme synojnë të inkurajojnë dhe rrisin pjesëmarrjen politike të të rinjve:

Të vendosen kuota për përfaqësimin e të rinjve në Parlament dhe të ofrohen incentiva për partitë politike

Një hap i parë praktik është vendosja e kuotave që sigurojnë që një numër i caktuar kandidatësh në listat zgjedhore për deputet në parlament të jenë nën moshën 30 vjeç. Kjo do të garantonte praninë e zërave të rinj në proceset legjislativë dhe do të krijonte mundësi për përfshirjen e tyre. Partitë politike që adoptojnë dhe zbatojnë kuotat për të rinjtë duhet të stimulohen, për shembull përmes mbështetjes financiare, si një formë vlerësimi e angazhimit të tyre në rinovimin e brezave.

Të krijohen Akademi Politike dhe Platforma Trajnimi në të gjitha partitë politike

Zhvillimi i programeve të lidërshit rinor të fokusuar në mentorim dhe aftësitë thelbësore, të tilla si të folurit në publik, analiza e politikave dhe menaxhimi i fushatave, do të përgatisë të rinjtë për karrierë të suksesshme në politikë. Duke u bazuar në shembuj pozitivë si nismat "Deputeti që Duam" ose "Akademia Politike", çdo parti politike duhet të krijojë akademitë dhe platformat e veta të trajnimit. Këto do të ofronin një hapësirë të strukturuar ku të rinjtë mund të fitojnë njohuri politike, aftësi udhëheqëse dhe ekspozim ndaj vlerave të partisë, duke i ndihmuar ata gjithashtu të bëjnë zgjedhje të informuara se ku ndihen më të përfaqësuar. Për të siguruar që të kenë impakt, akademitë politike nuk duhet të kufizohen vetëm në periudhat parazgjedhore, por duhet të funksionojnë vazhdimisht gjatë gjithë vitit.

Të kombinohen njohuritë me eksperiencën praktike

Mundësitë për trajnim duhet të shoqërohen dhe me eksperiencë praktike. Akademitë politike duhet të përfshijnë praktika pune, mentorime dhe mundësi për vëzhgim në punë gjatë detyrës (job shadowing) të ministrave, zëvendësministrave ose anëtarëve të parlamentit. Programe të tilla mund të pajisin të rinjtë me aftësi reale, të rrisin vetëbesimin e tyre, si dhe të thyejnë paragjykimet për mungesën e përvojës, një nga pengesat më të zakonshme me të cilat të rinjtë përballen për tu emëruar në pozicione drejtuese.

Të ndërmerren fushata rekrutimi dhe të ofrohen mundësi të barabarta

Partitë politike duhet të zhvillojnë gjithashtu fushata aktive rekrutimi që synojnë të rinjtë në të gjithë Shqipërinë, veçanërisht ata jashtë zonave urbane, për të siguruar që mundësitë të jenë gjithëpërfshirëse dhe të arritshme në të gjithë vendin. Në nivel lokal, duhet t'i kushtohet vëmendje rritjes së pjesëmarrjes së vajzave dhe grupeve të tjera të nën-përfaqësuar, duke përforcuar balancën gjinore dhe diversitetin brenda strukturave politike.

Të rritet ndërgjegjësimi dhe të nxitet interesi i hershëm në politikë

Përtej strukturave partiake, përpjekjet afatgjata duhet të fillojnë fillimisht brenda sistemit arsimor duke rritur ndërgjegjësimin rreth pjesëmarrjes aktive politike dhe angazhimit qytetar. Shkollat dhe universitetet duhet t'u ofrojnë të rinjve mundësi për të mësuar rreth proceseve demokratike, debatit dhe institucioneve politike, duke nxitur një interes që mund të rris përfshirjen në të ardhmen. Nisja nga niveli lokal me këshillat rinor në shkolla, këshillat vendor rinor në bashki dhe fushatat ndërgjegjësuese komunitare, dhe më pas zgjerimi në nivel kombëtar, mund të krijojë një bazë e fortë për angazhim politik.

Të ngrihen Qendra Rinore dhe Qendra Shumëfunksionale në qytetet ku mungojnë

Për të plotësuar punën e Këshillave Vendor Rinor dhe për të siguruar mundësi të barabarta për pjesëmarrjen e të rinjve në të gjithë Shqipërinë, është thelbësore të krijohen qendra rinore, hapësira multifunksionale dhe qendra të edukimit digjital, të ngjashme me TUMO-n në Tiranë, në të gjitha qytetet ku këto struktura mungojnë aktualisht. Këto qendra do t'u ofronin të rinjve akses në programe edukimi, zhvillim aftësish dhe aktivitete sociale, duke ndihmuar në kapërcimin e boshllëqeve në angazhim e tyre dhe duke ofruar mundësi të barabarta për përfshirje pavarësisht nga vendndodhja gjeografike.

Të nxitet dhe të mbështetet formimi dhe zhvillimi i Organizatave Rinore në të gjithë vendin

Institucionet qendrore dhe autoritetet lokale duhet të promovojnë dhe nxisin në mënyrë aktive krijimin e organizatave rinore në të gjithë Shqipërinë. Të dhënat tregojnë se të rinjtë që banojnë në qytete me struktura të tilla dhe organizata rinore aktive janë më të angazhuar dhe marrin pjesë vazhdimisht në jetën sociale dhe politike.

Këto organizata mund të funksionojnë në partneritet me ministrinë përgjegjëse për rininë dhe Këshillat Vendor Rinor për të mobilizuar të rinjtë, për të siguruar pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe për të ofruar platforma për zhvillimin e aftësive dhe angazhimin politik dhe social të të rinjve. Inkurajimi i formimit të organizatave rinore të udhëhequra veçanërisht nga vetë të rinjtë mund të forcojë rrjetet lokale, të nxisë aftësitë udhëheqëse, dhe të rrisë kapacitetet e tyre për t'u angazhuar në politikat publike dhe iniciativat komunitare.

Të sigurohet koordinimi midis institucioneve (Ministrive dhe Qeverisjes Vendore) për të adresuar nevojat e të rinjve

Institucionet qendrore dhe ato vendore duhet të koordinojnë iniciativat, projektet dhe përpjekjet e tyre që lidhen me çështjet rinore. Një qasje e tillë e integruar mundëson ofrimin e shërbimeve të përshtatura dhe me cilësi të lartë, të cilat u përgjigjen drejtpërdrejt prioriteteve dhe sfidave me të cilat përballen të rinjtë. Një koordinim efektiv ndër-institucional rrit koherencën e politikave, shmang mbivendosjen dhe duplikimin e programeve, si dhe siguron përdorim më efikas të burimeve.

Të integrohen perspektivat rinore në të gjitha Ministrinë dhe Institucionet e Qeverisjes Vendore

Çështjet rinore nuk duhet të kufizohen vetëm në një ministri të vetme ose në programe të izoluara, por duhet të integrohen në të gjithë spektrin e politikave publike. Çdo ministri dhe organ i qeverisjes vendore, duhet të marrë në konsideratë sistematikisht nevojat, aspiratat dhe pjesëmarrjen e të rinjve në hartimin dhe zbatimin e punës së tyre. Kjo do të thotë, të sigurohet që ligjet, rregulloret, shërbimet dhe mundësitë të përshtaten për të reflektuar realitetet e të rinjve me qëllimin për të nxitur përfshirjen e tyre. Një përjasje e tillë do të integronte një këndvështrim rinor në të gjitha fushat e qeverisjes: arsim, punësim, shëndetësi, mjedis, kulturë dhe më gjerë, duke siguruar kështu që të rinjtë nuk janë vetëm përfitues të politikave, por edhe kontribues aktivë në formësimin e tyre.

Të promovohet barazia gjinore dhe mundësitë e lidërshiptit për vajzat

Duke pasur parasysh uljen e përfaqësimit gjinor në nivel kombëtar dhe përfaqësimin e ulët të vajzave në role drejtuese në nivel lokal, janë të nevojshme iniciativa të synuara për të promovuar barazinë gjinore në pjesëmarrjen politike. Politikat dhe programet duhet të mbështesin veçanërisht vajzat në ndjekjen e roleve drejtuese, veçanërisht në pozicione si kryetare bashkie dhe role drejtuese brenda tyre, për të siguruar përfaqësim të barabartë. Duke nxitur lidërshiptin midis vajzave, Shqipëria mund të rrisë diversitetin në vendimmarrje dhe të krijojë struktura qeverisëse më gjithëpërfshirëse.

Rekomandime për pjesëmarrjen sociale të të rinjve

Ky sesion synon të ofrojë rekomandime politikash, njohuri dhe strategji për palët e interesuara dhe institucionet për të adresuar dhe avokuar në mënyrë efektive për ndryshime pozitive të politikave në fushën e të rinjve.

REKOMANDIME PËR ZHVILLIMIN E NJË SISTEMI TË DETAJUAR DHE GJITHËPËRFSHIRËSE PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE PËR TË RINJTË

Të vendoset një standard kombëtar i detyrueshëm për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave të disagreguara për të rinjtë

Të prezantohet një standard ligjërshët i detyrueshëm, që u kërkon të gjitha institucioneve, agjencive dhe programeve publike përkatëse të mbledhin, përpunojnë dhe publikojnë në mënyrë sistematike të dhëna mbi të rinjtë sipas grupmoshës së përcaktuar në nivel kombëtar (15-29 vjeç), si dhe grupmoshave të tjera sipas nevojës. Të dhënat duhet të jenë të detajuara dhe të disagreguara në mënyrë të plotë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- **Gjini:** për të identifikuar dhe adresuar pabarazitë midis vajzave dhe djemve.
- **Statusi i aftësisë së kufizuar:** për të pasqyruar situatën e të rinjve me aftësi të kufizuara fizike, shqisore ose intelektuale, duke u siguruar që nevojat e tyre specifike të jenë të dukshme.
- **Vendndodhja gjeografike (urbane/rurale, bashki/rajon):** për të reflektuar pabarazitë territoriale, veçanërisht pasi të rinjtë në zonat rurale përballen me varfëri më të lartë dhe me më pak mundësi.
- **Situata socio-ekonomike (të ardhurat e familjes, arsimi i prindërve, statusi i punësimit, etj):** për të kuptuar se si origjina sociale ndikon në situatën e të rinjve.
- **Përkatësia etnike ose minoritare:** veçanërisht për komunitetet rome, egjiptiane dhe komunitete të tjera të marginalizuara që përballen me përjashtim të vazhdueshëm.
- **Statusi i migracionit:** duke përfshirë migrantët e brendshëm (të rinjtë që lëvizin nga zonat rurale drejt Tiranës ose qyteteve të tjera), të rikthyerit nga jashtë (emigracioni) dhe familjet e emigrantëve.
- **Tregues të tjerë të vulnerabilitetit:** si statusi NEET (as në punë, as në arsim, as në trajnim), prindërimi i vetëm ose të rinjtë që largohen nga kujdesi institucional.

Ky standard duhet të përcaktojë një metodologji të qartë dhe të unifikuar për të gjithë institucionet, indikatorë dhe afate kohore raportimi të qarta, duke siguruar që informacioni të jetë konsistent, i krahasueshëm dhe i aksesueshëm nga të gjithë sektorët dhe institucionet.

Të ngrihet një sistem i centralizuar për menaxhimin e të dhënave për rininë

Pas prezantimit të një standardi kombëtar të detyrueshëm për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave, është thelbësore të ndërtohet infrastruktura për zbatimin e tij, duke u koordinuar ngushtë me INSTAT, si institucioni kombëtar përgjegjës për statistikën. Një sistem i centralizuar dhe i integruar i menaxhimit të të dhënave duhet të konsolidojë informacionin që lidhet me të rinjtë nga të gjitha institucionet në një platformë të vetme, transparente dhe të besueshme. Ky sistem duhet të zbatojë metodologji të standardizuara, të garantojë mbrojtje të konfidencialitetit për të fituar besimin e të rinjve dhe të jetë miqësor për përdoruesit dhe i aksesueshëm për politikëbërësit dhe institucionet përkatëse. Një sistem i tillë do të mundësonte masa të targetuara, efektive dhe gjithëpërfshirëse që i përgjigjen nevojave reale të të rinjve.

Të zhvillohet një platformë kombëtare e të dhënave për të rinjtë

Duke u bazuar në sistemin e centralizuar të menaxhimit të të dhënave, duhet të krijohet një Platformë Kombëtare e të Dhënave për të Rinjtë, e cila do të jetë e hapur për publikun. Kjo platformë do të përfshijë dhe vizualizojë të dhënat nga burime të ndryshme (p.sh., INSTAT, sigurimet shoqërore, drejtoria e burgjeve, universitetet), duke ofruar në kohë reale një pasqyrë të indikatorëve kryesorë për rininë.

Duke e bërë informacionin të aksesueshëm jo vetëm për politikëbërësit, por edhe për studiuesit, shoqërinë civile dhe vetë të rinjtë, platforma do të forcojë transparencën, llogaridhënien dhe do të krijojë një databazë të unifikuar të dhënash për të informuar hartimin e politikave që synojnë varfërinë e të rinjve, arsimin, punësimin dhe mbrojtjen sociale.

Praktika të mira ndërkombëtare nga vende si Suedia, Estonia, Kanadaja dhe Zelanda e Re:

X-Road është një platformë e sigurt e shkëmbimit të të dhënave që integron sisteme informacioni të ndryshme, si regjistri i popullsisë në sektorin publik dhe privat nëpërmjet platformës e-Estonia. Kjo mundëson ndarjen e të dhënave që mund të ndërveprojnë në kohë reale, duke ruajtur privatësinë gjatë ndarjes së tyre midis agjencive qeveritare.

Suedi: MONA (Akses online në mikrodata) dhe Mjeti Anketues LUPP

- MONA është një platformë e sigurt e menaxhuar nga "Statistics Sweden"(SCB), e cila u ofron studiuesve akses të autorizuar në mikro të dhëna. Analistët mund të përpunojnë të dhëna brenda platformës pa i nxjerrë të dhënat jashtë platformës, duke garantuar konfidencialitet të lartë.
- LUPP (Ndjekja Lokale e Zhvillimeve në Politikat Rinore) është një anketë/pyetësor për të rinjtë në nivel bashkie e administruar nga Agjencia Suedeze për Rininë dhe Shoqërinë Civile. Që nga viti 2003, ajo mbledh të dhëna mbi mirëqenien e të rinjve, kushtet e jetesës dhe angazhimin qytetar të të rinjve në të gjitha bashkitë. Të dhënat e saj ndihmojnë në informimin e politikave rinore si në nivel lokal ashtu edhe në atë kombëtar. OECD

Zelanda e Re: Të dhënat për rininë nga "Aotearoa" dhe Platformat e Mirëqenies së Fëmijëve dhe të Rinjve nga Community Insights

- Aotearoa Youth Figures, zhvilluar nga Figure.NZ me mbështetjen e Stats NZ, është një platformë kërkimi falas që mbledh të dhënat e të rinjve nga mbi 175 organizata, duke përfshirë të dhëna demografike, sociale dhe të mirëqenies, në një faqe të vetme të aksesueshme.
- Platformat e Mirëqenies së Fëmijëve dhe të Rinjve (Child & Youth Wellbeing Dashboards), të krijuara nga Community Insights në partneritet me agjenci të shumta qeveritare (Ministria e Shëndetësisë, Stats NZ, Education Counts), ofrojnë dashboard-e interaktive tematike që paraqesin statistikën e popullsisë së të rinjve, arsimin, shëndetësinë, mirëqenien sociale dhe pjesëmarrjen ekonomike, të gjitha përditësohen rregullisht për vendimmarrje lokale.

Kanada: Laboratori i të Dhënave për Rininë, Mjet i vizualizimit të portretit të të rinjve dhe Qendra e të Dhënave për Shëndetin Mendor të të Rinjve

- Laboratori i të Dhënave për Rininë (Youth Data Lab) është një portal me të dhëna të hapura i mbështetur nga "Youthful Cities". Ai grumbullon perspektivat e të rinjve nëpërmjet anketave, intervistave dhe të dhënave sasiore nga më shumë se 65 qytete kanadeze, duke i bërë këto informacione të arritshme për politikëbërësit dhe organizatat.
- Portreti i të Rinjve në Kanada (Portrait of Youth in Canada) është një mjet vizualizimi i të dhënave i përgatitur nga "Statistics Canada". Ai ofron vizualizime interaktive në shumë dimensionë, shëndet mendor dhe fizik, arsim, punësim, pjesëmarrje sociale dhe më shumë, për të mbështetur hartimin e politikave të synuara për rininë.
- Qendra e të Dhënave për Shëndetin Mendor të të Rinjve është një platformë publike e parë e këtij lloji që ofron të dhëna të detajuara mbi trendet e shëndetit mendor të të rinjve, të aksesueshme për politikëbërësit, studiuesit, profesionistët e shëndetit mendor dhe advokuesit për rininë.

Për Shqipërinë, ndjekja e një përjasjeje të ngjashme mund të përmirësojë ndjeshëm hartimin e politikave të bazuara në të dhëna dhe të forcojë monitorimin e progresit të përfshirjes dhe pjesëmarrjes sociale të të rinjve.

REKOMANDIME PËR TË PËRMIRËSUAR MUNDËSITË PËR PËRFSHIRJE, MBROJTJE SOCIALE DHE PUNËSIM PËR TË RINJTË VULNERABËL

Të ndërmerren masa aktivizimi specifike për të rinjtë brenda ndihmës ekonomike, për të

kaluar nga transfertat pasive të parave në programe që kombinojnë mbështetjen financiare me mundësi drejt aftësive dhe punësimit.

Të reformohet programi i ndihmës ekonomike duke përfshirë një model të "të ardhurave nga pjesëmarrja". Përfituesit e moshës 15-29 vjeç mund të marrin një pagesë pak më të lartë, me kusht që të marrin pjesë në aktivitete të certifikuara: formimi profesional, kurse gjuhe, programe të alfabetizimit digjital ose shërbim komunitar. Nëpërmjet kësaj përjasje qeveria investon në kapitalin njerëzor, ndërkohë që ofron ndihmë financiare.

Praktikë e Mirë: Portugalia: Programi Escolhas

- targeton të rinjtë në situata socio-ekonomike vulnerabël, veçanërisht pakicat etnike, dhe kombinon arsimin formal dhe joformal, formimin profesional dhe angazhimin komunitar për të promovuar përfshirjen sociale dhe për të parandaluar ciklet e varfërisë.

Të Identifikohen dhe hartëzohen të rinjtë vulnerabël

Për të adresuar në mënyrë efektive varfërinë e të rinjve dhe për të reduktuar pabarazitë gjinore, përparësia e parë duhet të jetë identifikimi dhe hartëzimi i të rinjve vulnerabël, me fokus të veçantë në zonat ku varfëria (veçanërisht e vajzave) është më e lartë.

Ky hartëzim i të rinjve mundëson hartimin e iniciativave lokale që i përgjigjen realiteteve specifike socio-ekonomike të secilës zonë.

Të zbatohen programe të fuqizimit ekonomik të ndjeshme ndaj gjinisë – masa për reduktimin e varfërisë

Duke u bazuar në hartëzimin e të rinjve vulnerabël, duhet të krijohen programe të fuqizimit ekonomik me qasje gjinore për të adresuar drejtpërdrejt hendekun prej 2.5% të rrezikut të varfërisë midis vajave dhe djemve, si dhe për të adresuar barrierat strukturore që i bëjnë vajzat më vulnerabël.

Këto programe duhet të përfshijnë formim profesional për aftësi që përputhen me kërkesat e tregut, praktika pune fleksibël dhe shërbime ndërmjetësimi për punësim. Këto masa duhet të kombinohen me iniciativa që ofrojnë subvencione ose incentiva tatimore për bizneset që punësojnë vajzat.

Njëkohësisht është e rëndësishme që këto masa të shoqërohen me shërbime cilësore dhe me çmime të përballueshme për kujdesin ndaj fëmijëve, si dhe subvencione për nënat e reja në zonat urbane dhe rurale, për tu mundësuar atyre të punojnë dhe/ose të studiojnë. Për më tepër, duhet të promovohen kushte pune fleksibël për të mbështetur pjesëmarrjen e vajzave në tregun e punës, duke adresuar nivelin e lartë të rrezikut të varfërisë me të cilin ato përballen.

Të reformohen strategjitë e reduktimit së varfërisë midis të rinjve

Strategjitë për uljen e varfërisë duhet të reformohen për të mbështetur më mirë të rinjtë në rrezik varfërie. Programet e ndihmës financiare duhet të përfshijnë kritere specifike për të rinjtë, të tilla si bonuse për regjistrimin në arsim, subvencione transporti për punëkërkuuesit dhe incentiva për punëdhënësit që të punësojnë të rinj.

Të prezantohen skema që targetojnë punësimin e të rinjve

Duhet të zhvillohen programe që mbështesin të rinjtë (veçanërisht vajzat) në aksesin në punë të denja përmes praktikave të punës, subvencioneve të pagave dhe granteve për sipërmarrje.

Të sigurohet mbështetje e personalizuar bazuar në të dhëna

Të gjitha masat që ndërmerren duhet të bazohen në të dhëna dhe nevojat e të rinjve, duke siguruar që çdo i ri i identifikuar të marrë mbështetje të përshtatur. Një qasje e koordinuar duhet të integrojë mundësitë e punësimit, formimit dhe aksesit në arsim, së bashku me masa të targetuara për vajzat, për të krijuar mundësi të qëndrueshme për dalje nga varfëria dhe për të kaluar drejt pjesëmarrjes aktive sociale dhe ekonomike.

Të përmirësohet mbulimi i mbrojtjes sociale

Duhet të thjeshtohen procedurat e aplikimit dhe të zgjerohen kriteret e përfitimit nga skemat e mbrojtjes sociale për të siguruar që të rinjtë vulnerabël (NEET, zonat rurale, nënat beqare) të kenë akses në ndihmë ekonomike pa barrierë.

REKOMANDIME PËR FORCIMIN E KORNIZAVE INSTITUCIONALE TË DREJTËSISË PËR PARANDALIMIN, REHABILITIMIN DHE RIINTEGRIMIN E TË RINJVE PAS BURGIMIT

Të rritet bashkëpunimi midis sektorit të drejtësisë dhe sektorit social

Të nxiten partneritete midis institucioneve penale, agjencive rinore, OJF-ve dhe qeverisjes vendore për të adresuar arsyet kryesore të sjelljes delikuede tek të rinjtë.

Identifikimi i hershëm dhe ndërhyrje për të rinjtë në rrezik delikuece

Institucionet duhet të bashkëpunojnë me shkollat dhe organizatat komunitare për të identifikuar djemtë dhe vajzat e moshës 12-17 vjeç që shfaqin faktorë rreziku për delinkuencë.

Duhet të ofrohen programe mentorimi, këshillim për shëndetin mendor dhe seminare për edukimin ligjor për të adresuar sfidat kryesore të të rinjve përpërpara përfshirjes në veprimtari kriminale.

Duhet të financohen dhe mbështeten programe komunitare që ofrojnë alternativa pozitive ndaj krimit, të tilla si konkurset sportive, programet e muzikës dhe arteve, aktivitetet profesionale dhe mentorimi nga figura mashkullore me influencë. Këto programe ofrojnë një ndjenjë përkatësie dhe nxisin angazhim pozitiv dhe zhvillimin e aftësive sociale.

Të zgjerohen programet e diversionit dhe drejtësisë ripërtëritëse

Të hartohen ligje dhe të financohen programe të diversionit para gjyqimit për të rinjtë që kryejnë vepra penale, jo të dhunshme, për herë të parë. Këto programe duhet të përfshijnë ndërmjetësim me viktimat, shërbim komunitar, mentorim dhe kurse rehabilituese në vend të dënimeve me burgim. Kjo redukton etiketimin negativ të një dosje penale dhe është vërtetuar se ul recidivizmin (përsëritjen e krimit).

Praktikë e Mirë: Shërbimet e ndërmjetësimit për të rinjtë në Norvegji

Qasja e Norvegjisë ndaj drejtësisë për të rinjtë është e njohur për fokusin e saj në rehabilitim dhe jo në ndëshkim. Institucionet e tyre përqendrohen në arsim, terapi dhe ndërtimin e aftësive jetësore në një mjedis normal. Ndërsa një reformë e plotë në këtë shkallë kërkon kohë, Shqipëria mund të fillojë duke pilotuar një njësi të vetme rehabilituese të paraburgimit për të mitur dhe të rinjtë, bazuar në këto parime.

Të ndërtohen partneritete me institucionet arsimore dhe profesionale

Të gjitha institucionet e paraburgimit dhe dënimit për të miturit dhe të rinjtë duhet të bashkëpunojnë me institucione profesionale dhe arsimore, për të siguruar që të rinjtë e burgosur të mund të fitojnë kredite ose certifikime të transferueshme.

Duhet të zgjerohet aksesimi në arsimimin për shkrim-lexim, aftësi teknike dhe aftësi jetësore për të rritur mundësitë për punësim pas lirimit.

Duhet të përdoren modelet e të nxënësve në distancë (online) dhe ato hibride për të ruajtur vijimësinë arsimore gjatë vuajtjes së dënimit.

Të zhvillohen programe të mbështetjes pas lirimit nga burgimi (Programet e Rehabilitimit dhe Riintegrit: për të parandaluar rikthimin e veprës penale)

Duhet të forcohen programet e rehabilitimit që kombinojnë arsimin, formimin profesional, dhe mbështetjen psikosociale për të ulur recidivizmin.

Të krijohet një "Partneritet Riintegrimi" ndër-institucional për çdo të ri që lirohet nga burg. Ky partneritet, duhet të përfshijë sistemin e mirëqenies sociale (shërbimet sociale), zyrën e punësimit dhe një organizatë lokale, për të krijuar një plan të personalizuar për strehim, vazhdimin e edukimit dhe sistemin në punë, duke ofruar stabilitet dhe një rrugë të qartë përpara.

Duhet të krijohen rrjete punëdhënësish për “Një Shans të Dytë” për të nxitur bizneset të punësojnë të rinj ish-të burgosur përmes incentivave tatimore, mentorimit dhe vlerësimit publik.

Praktikë e Mirë: Programet e Gjermanisë nga burgu në punësim

Ky program lidh të burgosurit me kompani të mundshme për punësim përpara liritë të tyre nga burgu.

Të ndërmerren qasje specifike për gjininë

Edhe pse vajzat përfaqësojnë një përqindje të vogël, duhet të zhvillohen masa mbështetëse të përshtatura për vajzat e burgosura (mbështetje psikosociale, mbrojtje nga paragjykimet pas liritë). Dhe të sigurohet që ato të kenë akses të barabartë në programet e rehabilitimit dhe shërbimet mbështetëse.

REKOMANDIME PËR TË PËRMIRËSUAR AKSESIN NË SHËRBIMET E MIRËQENIES SOCIALE, PËRFSHIRJEN E TË RINJVE DHE MASAT E AKTIVIZIMIT

Të detyrohet me ligj mbledhja e të dhënave të disagreguara dhe raportimi transparent i të dhënave

Të përmirësohet mbledhja, raportimi dhe monitorimi i të dhënave të disagreguara për të rinjtë. Institucionet duhet të mbledhin sistematikisht të dhëna të ndara sipas moshës dhe gjinisë. (Si përshkruhet edhe në rekomandimet më sipër). Ky është hapi i parë thelbësor.

Praktikë e Mirë: Modeli i Suedisë me platformën statistikore me akses të hapur: Socialstyrelsen (Bordi Kombëtar i Shëndetit dhe Mirëqenies)

Publikon të dhëna statistikore mbi shëndetin, shërbimet sociale, mirëqenien e fëmijëve etj. Të dhënat e disagreguara janë në dispozicion të publikut, të ndara sipas gjinisë, moshës, dhe zonës gjeografike. Ato përfshijnë statistika mbi shërbimet sociale për fëmijët dhe të rinjtë.

Të thjeshtohet aksesin në shërbime dhe të zhvillohen strategji proaktive për informim. Sistemi i mirëqenies sociale nuk duhet të presë për aplikime; ai duhet të identifikojë të rinjtë që kanë nevojë dhe të drejtë për të përfituar nga këto shërbime

Shumë të rinj përballen me pengesa administrative në arritjen e shërbimeve sociale. Ndaj, punonjësit social duhet të trajnohen për të kryer aktivitete informuese në shkollë, universitete dhe qendra komunitare për të informuar të rinjtë rreth mbështetjes në dispozicion që ata mund të përfitojnë, sipas situatës në të cilën ndodhen.

Duhet të përdoren kanale komunikimi miqësore për të rinjtë (rrjetet sociale, aplikacionet e mesazheve) për të shpërndarë informacion mbi të drejtën për të përfituar, kriteret e përfitimi dhe procedurat e aplikimit. Prezantimi i aplikacione digjitale dhe njësive lëvizëse informuese (shembull: platformat e qeverisjes elektronike të Estonisë) mund ti bëjnë aplikimet për ndihmë sociale më të lehta.

Të kryehet një "Auditim mbi Lehtësinë e Aksesit të shërbimeve të mirëqenies sociale": i fokusuar specifikisht tek të rinjtë

Një strukturë e pavarur, me përfaqësues të organizatave rinore, duhet të rishikojë kriteret e përfitimit, proceset e aplikimit dhe nivelin e informimit për të gjitha programet e ndihmës sociale. Auditimi duhet të identifikojë barrierat e panevojshme burokratike, problemet e përjashtimit të mundshëm që lindin nga përdorimi i mjeteve digjitale (p.sh., kërkesa për aplikime online pa orinetim dhe mbështetje si të plotësohen, etj.,) dhe të propozojë thjeshtëzime për ta bërë sistemin më të aksesueshëm për të rinjtë.

Të sigurohet mirëqenie psikosociale dhe gjithëpërfshirje

Duhet të sigurohet që të rinjtë të kenë akses në këshillim, shërbime të shëndetit mendor dhe mentorim për të adresuar traumën dhe diskriminimin shoqëror.

Të krijohen klube rinore dhe rrjete me bashkëmoshatarët e tyre (peer to peer) për të nxitur përfshirjen, vetëbesimin dhe qytetarinë aktive.

Stafi dhe kujdestarët që ofrojnë shërbimet e mirëqenies sociale duhet të trajnohen mbi "kujdesin e informuar mbi traumën" dhe përqasjet që kanë në fokus të tyre fuqizimin e të rinjve.

Të ofrohet mbështetje për tranzicionin dhe jetesën e pavarur

Qeveria duhet të hartojë programe të personalizuar tranzicioni për të rinjtë që dalin nga skemat e kujdesit social, duke përfshirë mbështetje për strehim, edukim financiar dhe ndërmjetësim për punësim.

Duhet të krijohen rrjete mentorimi që lidhin të rinjtë që dalin nga kujdesi social/shëndetësor me modele pozitive të komunitetit dhe profesionistë, të cilët mund t'i udhëheqin dhe mbështesin gjatë këtij tranzicioni.

Gjithashtu duhet të përgatitet një "Plan Pavarësie" për të rinjtë, i cili përshkruan hap pas hapi veprimet e nevojshme dhe se çfarë duhet të bëjnë për pavarësimin dhe kombinon trajnime, zhvillimin e aftësive praktike me mbështetjen për strehim dhe ndihmën financiare.

Të promovohet punësimi gjithëpërfshirës dhe mundësitë që ofron sipërmarrja

Të krijohen skema punësimi në bashkëpunim me kompanitë private, duke përfshirë praktika profesionale dhe vende pune të përshtatura për të rinjtë që dalin nga kujdesi social.

Qeveria duhet të krijojë partneritete të strukturuar me aktorë si OJF-të dhe sipërmarrjet sociale që ofrojnë shërbime të kujdesit social, me qëllim që të sigurojë ofrimin e shërbimeve që institucionet publike nuk mund t'i ofrojnë të vetme, duke plotësuar kështu boshllëqet ekzistuese, veçanërisht në ofrimin e këtyre shërbimeve në zonat rurale dhe rajonet ku këto shërbime mungojnë.

Të mbështeten Sipërmarrjet Sociale (të cilat në Shqipëri fokusohen kryesisht në ofrimin e shërbimeve për grupet vulnerabël dhe punësimin e tyre) përmes granteve, mentorimit dhe incentivave për të zgjeruar shërbimet e tyre dhe për të nxitur punësimin e të rinjve të përfshirë në skemat e ndihmës sociale.

REKOMANDIME PËR TË PËRMIRËSUAR REGJISTRIMIN DHE DIPLOMIMIN E TË RINJVE NË SISTEMIN ARSIMOR SHQIPTAR

Të modernizohet kurrikula mësimore dhe të përafrohet me kërkesat e tregut të punës

Kurrikulat dhe programet universitare duhet të përditësohen për të reflektuar trendet, metodologjitë dhe zhvillimet më të fundit në industri, për të siguruar që të diplomuarit të jenë konkurrues në tregun e punës.

Të vendoset bashkëpunim midis punëdhënësve, universiteteve dhe institucioneve shtetërore për të zhvilluar programe që e përafrojnë arsimin e lartë me kërkesat e tregut të punës, duke integruar aftësitë praktike, praktika profesionale, dhe mundësi për mësim praktik në vendin e punës për të zhvilluar kompetencat përkatëse të nevojshme në industri.

Universitetet duhet të bashkëpunojnë me institucionet e punësimit për të kryer studime mbi aftësitë e nevojshme që mungojnë midis të rinjve, me qëllim identifikimin e njohurive dhe aftësive të kërkuara për punët në të tashmen por edhe në të ardhmen.

Të përmirësohet cilësia e arsimit të lartë dhe njohja e tij në nivel ndërkombëtar

Të adoptohen mekanizma vendor dhe ndërkombëtarë të sigurimit të cilësisë dhe akreditimit për të siguruar që universitetet përmbushin standardet e njohura.

Të forcohet besueshmëria dhe mobiliteti (lëvizshmëria) e të diplomuarve shqiptarë duke ofruar diploma të njohura ndërkombëtarisht.

Të investohet në cilësinë e mësimdhënies dhe të oforhen trajnime të vazhdueshme për zhvillimin profesional të stafit akademik, në mënyrë që të përvetësojnë metoda moderne pedagogjike dhe praktika inovative mësimdhënieje.

Të përmirësohet infrastruktura dhe kushtet e mësimdhënies në universitete

Mjediset e Universiteteve duhet të pajisen dhe modernizohen me laboratorë, mjete digjitale, biblioteka dhe burime mësimore të përshtatshme për të akomoduar të gjithë studentët në mënyrë efektive.

Të promovohen dhe të integrohen platforma digjitale të të nxënësve dhe sistemet e menaxhimit të mësimin (Learning Management Systems), me qëllim ofrimin e mundësive fleksibile të mësimin, në prezencë, online dhe të kombinuara.

Të nxitet aksesueshmëria dhe mundësitë e barabarta në arsimin e lartë

Të zgjerohen skemat e bursave dhe mbështetjes financiare për studentët në situata të pafavorizuara, nga familjet me të ardhura të ulëta, pjesë e sistemit të mirëqenies sociale, zonat rurale dhe studentët e parë të familjes së tyre që frekuentojnë arsimin e lartë, me synimin për të ulur pengesat financiare në aksesin e arsimit të lartë.

Të prezantohen programe për informim në shkollat e mesme për të informuar grupet e nën-përfaqësuar (p.sh., vajzat, të rinjtë romë, studentët në sistemin e mirëqenies sociale) rreth bursave dhe mundësive të arsimit të lartë. Për shembull, të organizohen ditë të hapura universitare në zonat rurale me qëllim për t'i sjellë universitetet më afër të rinjve ruralë, dhe për ti informuar mbi mundësitë për arsim të lartë.

Të zhvillohen platforma online me informacion të qartë dhe të aksesueshëm mbi kriteret e pranimeve, bursat dhe mundësitë për karrierë.

Të nxitet aksesueshmëria dhe barazia në arsimin e lartë

Të mbështeten studentët nga zonat e largëta, duke ofruar ndihmë për banim, subvencione për transport dhe infrastrukturën e nevojshme digjitale për të mësuar.

Të hartohen politika gjithëpërfshirëse dhe infrastrukturë e dedikuar për studentët me aftësi të kufizuara që të kenë akses logjistikisht në universitete.

Të prezantohet një format fleksibël studimi, programe studimi me kohë të pjesshme dhe të kombinuara për studentët që duhet të kombinojnë punën dhe studimin.

Të forcohen shërbimet e Këshillimit Profesional dhe Orientimit për Karrierën

Të promovohet dhe të rritet ndërgjegjësimi midis të rinjve rreth vlerave të programeve të këshillimit dhe orientimit për karrierën për ti ndihmuar ata të përafrojnë aftësitë, interesat dhe aspiratat e tyre për karrierë me zgjedhjet e arsimit të lartë dhe nevojat e tregut të punës.

Të zhvillohen aftësitë e mësuesve të orientimit për karrierën në të gjitha shkollat e mesme duke ofruar trajnime për të siguruar këshillim të qëndrueshëm dhe me cilësi të lartë.

Të ngrihen qendra profesionale për orientim për karrierën në të gjitha qytetet e Shqipërisë për të ofruar mbështetje të aksesueshme dhe me cilësi të lartë për të gjithë studentët.

Të nxitet përfshirja dhe mbajtja e studentëve në sistemin arsimor

Të forcohen programet e mentorimit dhe mbështetjes për të rinjtë, veçanërisht për studentët e vitit të parë nga grupet vulnerabël, për të përmirësuar përshtatjen dhe suksesin akademik.

Të sigurohet që shkollat dhe universitetet të ofrojnë shërbime akademike dhe psikologjike të aksesueshme për të ulur shkallën e braktisjes së studimeve.

Të zhvillohen programe mentorimi, këshillimi dhe asistence akademike për të ndihmuar studentët të qëndrojnë në studime dhe të kenë sukses.

Të krijohen mekanizma për rikthimin dhe rifillimin e studimeve për studentët që braktisin studimet për shkak të presioneve financiare, emigrimit, pa penalizime.

Të forcohet besimi dhe angazhimi me studentët

Të ndërtohen kanale të forta komunikimi dhe angazhimi midis universiteteve dhe studentëve për të rritur transparencën dhe besimin në sistemin e arsimit të lartë.

Të promovohen historitë e suksesit dhe arritjet e të diplomuarve për të treguar vlerën e arsimit të lartë dhe për të rritur besimin në ndjekjen e studimeve në universitetet në Shqipëri.

Të analizohen arsyet pse djemtë kanë norma më të ulëta përfshirje në arsimin e lartë krahasuar me vajzat dhe të adresohet ky hendek gjinor

Të kryhet një hulumtim/kërkim cilësor për të kuptuar faktorët nxitës që qëndrojnë pas zgjedhjeve të djemve (preferenca për profesione të kualifikuara, aspiratat për emigrim, etj.).

Përdorni gjetjet për të:

- Riorganizuar orientimin për karrierën në shkollat e mesme për të nxjerrë në pah opsione të ndryshme karriere që kanë vlerë të lartë, dhe që kërkojnë një diplomë universitare.
- Zhvilluar programe për informim dhe ndërgjegjësim në shkollat e mesme për të inkurajuar studentët meshkuj të ndjekin arsimin e lartë duke promovuar opsione të ndryshme karriere dhe modele të djemve të suksesshëm në fusha si inxhinieria, biznesi dhe teknologjia.
- Forcuar institucionet e formimit profesional për t'u siguruar që ato të konsiderohen një zgjedhje e mirë dhe e respektuar, jo një zgjedhje e detyruar për ata që ndihen të përjashtuar nga universiteti.
- Të ofrohen bursa, programe mentorimi dhe shërbime këshillimi të dedikuara për të mbështetur studentët djem, veçanërisht në fushat ku ata janë të nën-përfaqësuar.

REKOMANDIME PËR TË PËRMIRËSUAR RËNDËSINË DHE GJITHËPËRFSHIRJEN E STUDENTËVE ME KUALIFIKIME TË NIVELEVE TË AVANCUARA NË TREGUN E PUNËS

Të sigurohet që përfitimi i kualifikimeve të avancuara të çojë në punësim cilësor.

Të përfshihen dhe të financohen metoda të mësimi të integruar në punë (praktika profesionale të detyrueshme, programe bashkëpunimi universitet -biznes) si pjesë e programeve master dhe doktoraturë, duke i bërë këto nivele arsimore më tërheqëse dhe të vlefshme për studentët.

Të ofrohen incentiva për studime të avancuara në sektorët kyç, me qëllim mbajtjen e të rinjve të arsimuar në vend, veçanërisht vajzat.

Të krijohen "Fonde të Dedikuara për Studime Doktoraturë dhe Kërkime për Sektorë Specifik" në partneritet me kompani private në sektorë prioritarë si bujqësia (agroteknologjia), turizmi dhe energjia. Të ofrohen bursa dhe grante për studime kërkimi që lidhen me sfida të ndryshme të Shqipërisë, këto mundësi parandalojnë largimin e trurit (braindrain) dhe lejojnë zbatimin e njohurive të fituara në zhvillimin kombëtar.

Të zbatohet një fushatë ndërgjegjësores me në fokus djemtë në STEM: Për të mbyllur hendekun në arsimin në nivele të avancuara.

Institucionet mund të bashkëpunojnë me kompani teknologjike dhe lider të industrisë për të krijuar programe bursash dhe programe mentorimi të hartuara specifikisht për të inkurajuar të rinjtë të ndjekin dhe të përfundojnë studimet Master në fushat STEM, duke treguar mundësi karriere të qarta dhe fitimprurëse brenda Shqipërisë.

Të inkurajohet kthimi i studentëve që kanë studiuar jashtë vendi

Të inkurajohen shqiptarët që studiojnë jashtë vendit që të kthehen për të punuar në Shqipëri, përmes njohjes së diplomave, mundësive për kërkim shkencor, punësim dhe granteve për sipërmarrje.

Të ofrohen mundësi të barabarta profesionale

Ndërsa përfshirja e lartë e vajzave në arsim është pozitive, duhet të garantohet që arsimi i lartë të përkthehet në mundësi të barabarta në tregun e punës duke zbatuar paga të barabarta dhe duke luftuar diskriminimin në vendin e punës.

Rekomandime për pjesëmarrjen ekonomike të të rinjve

Prezantimi dhe zbatimi i strategjive të tilla si Strategjia Kombëtare për Rininë dhe Plan i Veprimit 2022-2029, Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023-2030 dhe Garancia Rinore përfaqësojnë hapa kryesor drejt krijimit të kushteve më të favorshme për të rinjtë në tregun e punës në Shqipëri.

REKOMANDIME PËR TË ULUR NUMRIN E TË RINJVE NEET

Të zhvillohet një qasje strategjike dhe fleksibël për zgjerimin e aktiviteteve për identifikimin dhe informimin e të Rinjve NEET

Të krijohet një kornizë kombëtare për zgjerimin dhe shtrirjen e aktiviteteve për informim dhe identifikim të NEET, e cila është fleksibël për tu përshtatur dhe zbatuar edhe në nivel lokal, me synimin për të adresuar nevojat specifike rajonale. Kjo strategji e koordinuar siguron koherencë në mënyrën se si të rinjtë NEET përcaktohen, identifikohen, kontaktohen dhe dokumentohen në të gjitha rajonet e Shqipërisë.

Të sigurohet komunikim i vazhdueshëm midis autoriteteve kombëtare, rajonale dhe lokale për të ruajtur koherencën dhe koordinimin.

Fokus në parandalimin dhe ndërhyrjen e hershme

Të zbatohen sisteme identifikimi të hershëm në shkollë për të identifikuar nxënësit në rrezik braktisjeje të shkollës.

Të ofrohen udhëzime dhe këshillim sistematik për karrierën për të ndihmuar të rinjtë të marrin vendime të informuara në lidhje me të ardhmen e tyre.

Të bashkëpunohet me shkollat për të ofruar mbështetje të personalizuar gjatë momenteve kyçe të tranzicionit arsimor.

Të Hartëzohen dhe Identifikohen të Rinjtë NEET

Të identifikohen dhe hartëzohen të rinjtë NEET për të kuptuar karakteristikat dhe vendndodhjet e tyre për ndërmarrjen e masave të synuara.

Të zhvillohen sisteme gjurmimi për të monitoruar tranzicionet e të rinjve nga arsimi në punësim dhe për të siguruar që ata të mos humbasin në këtë tranzicion.

Të adresohen barrierat ligjore dhe teknike për ndarjen e të dhënave midis aktorëve të interesuar.

Të përshtaten masat dhe strategjitë për nëngrupet e NEET - Adoptimi i një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe të përshtatur

Të kuptohet diversiteti i NEET (të rinj me aftësi të kufizuara, të papunë afatshkurtër, të papunë afatgjatë, vajza me përgjegjësi familjare, të rinj nga zonat rurale, romë dhe minoritete të tjera, të rinj në rrezik varfërie ose emigracioni, etj) dhe të hartohen aktivitete identifikimi, informimi dhe kontaktimi në terren që marrin parasysh këto ndryshime.

Të inkurajohet bashkëpunimi me organizatat me bazë në komunitet dhe ndërmjetësuesit kulturorë për të identifikuar dhe përfshirë grupet e marginalizuara, si minoritetet /pakicat etnike.

Të krijohen partneritete

Të ndërtohen partneritete midis bashkive, zyrave të punësimit, shkollave, qendrave rinore, shërbimeve sociale, OJF-ve dhe organizatave me bazë në komunitet për të ndarë të dhëna dhe për të kontaktuar në mënyrë aktive të rinjtë në zonat e tyre.

Të përcaktohen qartë rolet dhe përgjegjësitë midis partnerëve për të shmangur mbivendosjen dhe për të garantuar llogaridhënie.

Të përfshihen organizatat rinore dhe OJF-të për të përfituar nga ekspertiza dhe besimi që të rinjtë kanë te ata.

Të përdoren metoda proaktive dhe inovative të komunikimit

Të përdoren si mjetet institucionale (regjistrat administrativë, anketat, regjistrat e punësimit) ashtu edhe qasjet e bazuara në komunitet (peer outreach, OJF-të, dhe organizatat lokale) për të identifikuar të rinjtë NEET që përndryshe mund të mbeten të padukshëm.

Të angazhohen punonjës terreni, ekupe mbështetëse dhe njësi lëvizëse për të identifikuar të rinjtë të cilët janë të vështirë për t'u arritur.

Të prezantohen mjete digjitale, aplikacione në telefon dhe platforma online që e bëjnë më të lehtë regjistrimin dhe lidhjen me të rinjtë NEET, veçanërisht ata që jetojnë në zona të largëta ose të pashërbyera.

Të organizohen aktivitete, trajnime dhe panairë pune për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të ofruar mbështetje të drejtpërdrejtë.

Të investohet në ndërtimin e kapaciteteve të punonjësve të vijës së parë

Të ofrohen trajnime të targetuara për profesionistët dhe vullnetarët e përfshirë në identifikimin e NEET. Aftësitë kryesore duhet të përfshijnë angazhimin e të rinjve, komunikimin ndërkulturor, konfidencialitetin dhe ndjeshmërinë ndaj grupeve vulnerabël.

Të krijohen Qendra të Shërbimeve me një Ndalesë (One Stop Shop)

Të krijohen qendra të integruara ku të rinjtë mund të marrin informacion dhe shërbime të shumta (p.sh., punësim, arsim, shëndetësi, strehim) në një vend.

Të sigurohet që këto qendra të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe me punonjës me aftësi shumëdisiplinore.

Të Përfshihen të rinjtë në hartimin e programeve

Të angazhohen të rinjtë në hartimin dhe vlerësimin e programeve të informimit për t'u siguruar që ato u përgjigjen nevojave të tyre.

Të përdoren komentet dhe sugjerimet nga të rinjtë NEET për të përshtatur dhe përmirësuar shërbimet.

Të sigurohet financim i qëndrueshëm

Të shmanget financimi vetëm përmes projekteve afatshkurtra, dhe të sigurohen burime të qëndrueshme për identifikim dhe shpërndarjen e informacionit.

Të eksplorojnë burime të ndryshme financimi, duke përfshirë partneritetet publik-privat dhe mbështetje nga Fondi Social Evropian (ESF).

Të përmirësohet komunikimi dhe ndërgjegjësimi

Të përdoret një gjuhë e qartë dhe miqësore për të rinjtë në fushatat e komunikimit/informuese.

Të ndahen histori suksesi dhe përfshihen “të rinj model”, “influencer” për të frymëzuar të rinjtë.

Informacioni duhet të shpërndahet përmes kanaleve të ndryshme, duke përfshirë rrjetet sociale, shkollat dhe eventet komunitare.

Të monitorohen dhe vlerësohen programet

Të krijohen mekanizma për të ndjekur progresin, për të përditësuar rregullisht të dhënat, për të përshtatur metodat e identifikimit dhe për të siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve bazuar në të dhëna dhe sugjerime si nga praktikuesit ashtu edhe nga vetë të rinjtë.

Të vlerësohet rregullisht efektiviteti i strategjive të aktiviteteve të informimit dhe identifikimit dhe të përshtaten në bazë të rezultateve.

Të ofrohen mundësi me cilësi të lartë dhe të përshtatura për të rinjtë

Të ofrohen mundësi trajnimi, punësimi dhe arsimi që përmbushin standarde të larta dhe përputhen me nevojat, preferencat dhe aspiratat e të rinjve.

Të mësohet nga praktikrat e mira ndërkombëtare

Të analizohen sukseset dhe sfidat nga zbatimi i Garancisë Rinore në vendet e tjera për të nxjerrë mësim dhe identifikuar përjashtimet efektive.

Të përdoren të dhëna nga eksperiencat e kaluara për të rritur efikasitetin, funksionalitetin dhe ndikimin konkret të programeve për të rinjtë.

REKOMANDIME PËR TË PËRMIRËSUAR PUNËSIMIN E TË RINJVE NË SHQIPËRI

Të parandalohet tranzicioni nga papunësia afatshkurtër në atë afatgjatë

Ti jepet përparësi masave që mbështesin në mënyrë aktive të rinjtë e papunë përpara se të kalojnë në papunësi afatgjatë. Kjo mund të përfshijë programe ndërhyrjeje të hershme, këshillim të personalizuar për karrierën dhe masa të synuara aktivizimi për t'i mbajtur të rinjtë të lidhur me tregun e punës.

Të lehtësohet tranzicioni nga arsimi drejt punësimit

Të ngrihen zyra të dedikuara mentorimi që udhëheqin studentët që nga fazat e arsimimit të tyre deri në sigurimin e punësimit. Mentorët duhet të ofrojnë udhëzime të vazhdueshme profesionale për karrierën, t'i ndihmojnë të rinjtë në procesin e aplikimeve për punë dhe t'i mbështesin ata në zhvillimin e aftësive të buta dhe teknike të nevojshme nga tregu.

Të promovohen mundësitë e punësimit në Shqipëri

Të zhvillohen fushata ndërgjegjësuere dhe nisma informuese që prezantojnë mundësitë e punësimit që ofrohen brenda vendit, me fokus në sektorët në zhvillim, sipërmarrjen dhe mundësitë për zhvillim në nivel rajonal.

Të rritet pjesëmarrja e vajzave në forcën e punës

Të zbatohen masa afirmative që u japin vajzave mundësi më të mëdha në rekrutim dhe që sigurojnë që kandidatura e tyre të ketë përparësi aty ku ka mungesa.

Shërbimet mbështetëse, të tilla si kujdesi për fëmijët me çmime të përballueshme, kushte pune dhe oraret fleksibël, masat e mbrojtjes sociale dhe politikat për familjarët, duhet të zgjerohen për t'u mundësuar vajzave të balancojnë përgjegjësitë profesionale dhe personale.

Të rriten incentivat financiare dhe mundësitë për blerjen e shtëpive për të rinjtë dhe vajzat

Duhet të zgjerohen skemat e kredive të buta për banesë/shtëpi për të rinjtë dhe vajzat, duke ofruar instrumente financiare të favorshme që nxisin stabilitet dhe vendosje afatgjatë, dhe nga ana tjetër mbështesin punësimin e qëndrueshëm.

Të investohet në trajnime dhe zhvillimin e aftësive/ riaftësim

Të zgjerohen programet e trajnimit, riaftësimit dhe përmirësimit të aftësive për t'u përshtatur me kërkesat në ndryshim të tregut të punës, duke siguruar që të rinjtë të jenë të pajisur me aftësi të orientuara drejt së ardhmes në digjitalizim, ekonomi të gjelbër dhe sektorë të tjerë në rritje.

Të promovohet punësimi i të rinjve me aftësi të kufizuara

Vende Pune Gjithëpërfshirëse: Të inkurajohet krijimi i vendeve të punës të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse, të mbështetura me trajnime për punëdhënësit dhe punonjësit si mbi akomodimet fizike ashtu edhe mbi sjelljen dhe kulturën organizative gjithëpërfshirëse.

Persona Kontakti të Dedikuar: Të emërohet një staf i trajnuar brenda institucioneve dhe kompanive për të mbikëqyrur përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara dhe për të siguruar zbatimin efektiv të akomodimit të tyre.

Incentiva për Punëdhënësit: Të prezantohen incentiva financiare për punëdhënësit që punësojnë dhe mbajnë në punë të rinj me aftësi të kufizuara, duke nxitur integrimin e qëndrueshëm në tregun e punës.

Ndërgjegjësimi Publik: Të ndërmerren fushata ndërgjegjësimi që sfidojnë paragjykimet dhe theksojnë vlerën e punësimit të të rinjve me aftësi të kufizuara.

Mbështetje e Personalizuar: Të ofrohet mbështetje e personalizuar për të identifikuar aftësitë, pikat e forta dhe interesat e çdo të riu, dhe për t'i lidhur ata me mundësi të denja punësimi që përputhen me potencialin e tyre.

REKOMANDIME PËR RRITJEN E VETËPUNËSIMIT MIDIS TË RINJVE

Të lehtësohen procedurat e aplikimit për grante

Të thjeshtohen procedurat burokratike dhe të reduktohet numri i kërkesave të ndërlikuara dhe numri i hapve kompleksë për aplikimet për grante, pasi proceset e gjata i dekurajojnë të rinjtë dhe shpesh rezultojnë në tërheqjen e tyre nga aplikimi. Procedurat e thjeshtuara dhe miqësore për përdoruesit mund të rrisnin aksesueshmërinë dhe të inkurajojnë pjesëmarrje më të gjerë.

Të kombinohen grantet me trajnime

Mundësitë e financimit duhet të shoqërohen me sesione trajnimi që i pajisin të rinjtë me aftësitë praktike për të përgatitur aplikime të mira, për të menaxhuar financat dhe për të hartuar modele biznesi të qëndrueshme.

Kjo qasje e dyfishtë jo vetëm që forcon kapacitetin e të rinjve për të aplikuar, por gjithashtu ndihmon në pajisjen e tyre me aftësitë për të menaxhuar fondet në mënyrë më efektive, nëse shpallen fitues, duke rritur kështu qëndrueshmërinë dhe suksesin afatgjatë të sipërmarrjeve të drejtuara nga të rinjtë.

Të prioritetizohen grupet vulnerabël

Tu jepet përparësi aplikimeve dhe incentivave për të rinjtë nga zonat rurale, grupet e disavantazuara dhe të rinjve në përgjithësi, për të krijuar mundësi më gjithëpërfshirëse.

Të promovohet kultura e sipërmarrjes

Të promovohen historitë e suksesit të sipërmarrësve të rinj për të frymëzuar bashkëmoshatarët, për të nxitur një kulturë inovacioni dhe për të inkurajuar më shumë të rinj që ta shohin vetëpunësimin si një zgjedhje të vlefshme karriere.

Të integrohet sipërmarrja në kurrikulat arsimore

Sipërmarrja duhet të integrohet në sistemin arsimor duke përfshirë aftësitë, mendësinë dhe praktikën sipërmarrëse në të gjitha nivelet e arsimit, nga arsimi fillor deri në arsimin e lartë. Kjo përfshin përditësimin e kurrikulave me module praktike mbi kreativitetin, zgjidhjen e problemeve, edukimin financiar dhe planifikimin e biznesit; promovimin e të nxëniet të bazuar në projekte dhe rasteve të studimit nga jeta reale; nxitjen e partneriteteve midis shkollave, universiteteve dhe bizneseve; dhe krijimin e hapësirave si laboratorë inovacioni dhe sipërmarrjet studentore. Një program i tillë do të përgatisë të rinjtë të mendojnë në mënyrë kritike, të veprojnë në mënyrë inovative dhe të ndërtojnë vetëbesimin për të ndjekur vetëpunësimin dhe për të krijuar sipërmarrjet e tyre.

REKOMANDIME PËR PUNËSIMIN E TË RINJVE TË MOSHES 15-17 VJEÇ

Të nxitet pjesëmarrja e barabartë ekonomike që në moshat e hershme

Të ndërtohen programe që përfshijnë në mënyrë aktive vajzat në eksperiencë pune që në moshë të hershme, me synimin për të balancuar pabarazinë gjinore në punësimin e të rinjve.

Të ndërtohen programe të përgatitjes për punë në shkolla

Të zbatohen nisma për këshillimin për karrierën dhe zhvillimin e aftësive si për djemtë ashtu edhe vajzat përpara se të hyjnë në tregun e punës.

Të sigurohet punësimi i sigurt dhe ligjor për të rinjtë 15-17 vjeç

Të sigurohet zbatim i ligjeve të punës që mbrojnë të rinjtë nga shfrytëzimi. Të promovohen mundësi pune të denja dhe të përshtatshme për moshën, që ofrojnë paga të drejta, kushte të sigurta pune dhe mundësi për të mësuar dhe për tu zhvilluar profesionalisht. Bashkëpunimi midis institucioneve shtetërore, punëdhënësve dhe shoqërisë civile duhet të forcohet për të monitoruar zbatimin e ligjit, për të rritur ndërgjegjësimin tek të rinjtë për të drejtat e tyre dhe për të inkurajuar bizneset të adoptojnë praktika punësimi miqësore për të rinjtë.

Të rritet ndërgjegjësimi në familje dhe komunitet mbi punësimin e vajzave

Të rritet ndërgjegjësimi në familje dhe komunitete mbi përfitimet e punësimit të hershëm për të dyja gjinitë, duke adresuar paragjykimet kulturore që favorizojnë djemtë, dhe pengojnë vajzat.



SHTOJCA 1: SHËNIME METODOLOGJIKE

Që nga viti 2016, një sërë treguesish janë zgjedhur bazuar në një proces analitik që përfshin kërkime të gjera në tavolinë dhe konsultime me ekspertë. Me kalimin e viteve, janë paraqitur tregues të rinj për të matur më mirë pjesëmarrjen politike, sociale dhe ekonomike të të rinjve. Në Tabelën e mëposhtme janë renditur të gjithë treguesit, metoda e llogaritjes dhe burimet e të dhënave.

DIMENSIONI I PJESËMARRJES POLITIKE	METODA E LLOGARITJES SË TË DHËNAVE			BURIMI I TË DHËNAVE
INDIKATORËT	TË DHËNA	FEMËR	MASHKULL	
Ministrit e Rinj në Qeveri	Numri i ministrave të rinj (15-29) / Numri total i ministrave.	Numri i ministereve të reja femra (15-29) / Numri total i ministereve.	Numri i ministrave të rinj meshkuj (15-29) / Numri total i ministrave.	Hulumtim
Zëvendësministri të rinj në qeveri	Numri i zëvendësministrave të rinj (15-29) / Numri total i zëvendësministrave.	Numri i zëvendësministrave të reja femra (15-29) / Numri total i zëvendësministrave.	Numri i zëvendësministrave të rinj meshkuj (15-29) / Numri total i zëvendësministrave.	Hulumtim
Deputetët e rinj në parlament	Numri i deputetëve të rinj (15-29) / Numri total i deputetëve	Numri i deputeteve të reja femra (15-29) / Numri total i deputetëve	Numri i deputetëve të rinj meshkuj (15-29) / Numri total i deputetëve	Hulumtim
Kryetarë të rinj të bashkive	Numri i kryetarëve të rinj të bashkive (15-29) / Numri total i kryetarëve të bashkive	Numri i kryetareve të reja të bashkive (15-29) / Numri total i kryetarëve të bashkive.	Numri i kryetarëve të rinj të bashkive (15-29) / Numri total i kryetarëve të bashkive.	Hulumtim
Mjete on-line për informim dhe pjesëmarrje në vendimmarrjen e qeverisë dhe parlamentit	Mesatarja e (Numri i institucioneve publike në nivel qendror që kanë Instagram / Numri total i institucioneve publike në nivel qendror + (Numri i institucioneve publike në nivel qendror që kanë Facebook / numri total i institucioneve publike në nivel qendror) + (Numri i institucioneve publike në nivel qendror që kanë një faqe internet (website) / Numri i përgjithshëm i institucioneve publike në nivel qendror)	Jo e Aplikueshme	Jo e Aplikueshme	Hulumtim

DIMENSIONI I PJESËMARRJES POLITIKE		METODA E LLOGARITJES SË TË DHËNAVE		BURIMI I TË DHËNAVE
INDIKATORËT	TË DHËNA	FEMËR	MASHKULL	
Mjetet on-line për informim dhe pjesëmarrje në vendimmarrjen e bashkive	Mesatarja e (Numri i bashkive që kanë Instagram / Numri i përgjithshëm i bashkive) + (Numri i bashkive që kanë Facebook / Numri i përgjithshëm i bashkive) + (Numri i bashkive që kanë një faqe internet / Numri total i bashkive)	Jo e Aplikueshme	Jo e Aplikueshme	Hulumtim
Ekzistenca e strukturave rinore (këshillat / parlamentet / bordet) në nivel kombëtar	Numri i strukturave rinore në nivel kombëtar	Jo e Aplikueshme	Jo e Aplikueshme	Informacioni i dhënë nga Ministria e Rinisë dhe Fëmijëve dhe hulumtimi në zyrë
Ekzistenca e strukturave rinore (këshillat / parlamentet / bordet) në nivel lokal	Numri i bashkive që kanë strukturë rinore (këshilla, parlamente, sindikata) / Numri total i bashkive.	Jo e Aplikueshme	Jo e Aplikueshme	Informacioni i dhënë nga Bashkitë dhe Ministria e Rinisë dhe Fëmijëve
% e Buxhetit të Bashkive Dedikuar Rinisë	Mesatare e % të Buxheteve të Bashkive që e kanë ofruar këtë informacion	Jo e Aplikueshme	Jo e Aplikueshme	Llogaritur nga hulumtuesi sipas të dhënave të ofruara nga bashkitë e Shqipërisë

DIMENSIONI I PJESËMARRJES EKONOMIKE	METODA E LLOGARITJES SË TË DHËNAVE			BURIMI I TË DHËNAVE
INDIKATORËT	TË DHËNA	FEMËR	MASHKULL	
Shkalla e NEET	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)
Shkalla e papunësisë të të rinjve	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)
Shkalla e papunësisë afatgjatë të të rinjve	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)
Shkalla e pjesëmarrjes së forcës punëtore të të rinjve	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)
Shkalla e punësimit të të rinjve	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)
Të rinj që kanë filluar biznesin e tyre me mbështetjen financiare të shtetit	Numri i të rinjve (15-29) që morën mbështetje financiare nga qeveria (Ministritë) / Numri total i personave që morën mbështetje financiare nga qeveria (Ministritë)	Numri i femrave të reja (15-29) që morën mbështetje financiare nga qeveria (Ministritë) / Numri total i femrave që morën mbështetje financiare nga qeveria (Ministritë)	Numri i të rinjve meshkuj (15-29 vjeç) që morën mbështetje financiare nga qeveria (Ministritë) / Numri total i meshkujve që morën mbështetje financiare nga qeveria (Ministritë)	Informacion i ofruar nga Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
Përqindja e të rinjtve të vetëpunësuar	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)
Shpenzimet për Programet e Nxitjes së Punësimit	Shuma totale në lekë	Jo e Aplikueshme	Jo e Aplikueshme	Të dhënat të ofruara nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive

DIMENSIONI I PJESËMARRJES SOCIALE	METODA E LLOGARITJES SË TË DHËNAVE			BURIMI I TË DHËNAVE
INDIKATORËT	TË DHËNA	FEMËR	MASHKULL	
Të rinj në rrezik varfërie	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)
Përqindja e të varfërve (të rinjve që jetojnë nën kufirin e varfërisë) (Numri i të rinjve të varfër / numri i të rinjve)	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna
Të rinj në burgje	Numri i të rinjve (15-29) në burg / Numri total i personave në burg	Numri i femrave të reja (15-29) në burg / Numri total i personave në burg	Numri i të rinjve meshkuj (15-29) në burg / Numri total i personave në burg	Informacioni i dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
Të rinj pjesë e sistemit të mbrojtjes sociale (të cilët marrin mbështetje financiare nën sistemin e mbrojtjes sociale) pjesëtuar me të rinjtë që janë në sistemin e mbrojtjes sociale	Të rinj (15-29) përfitues të skemës së ndihmës ekonomike / Totali personave përfitues të skemës së ndihmës ekonomike	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Informacioni i dhënë nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)
Braktisja e shkollës së mesme	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna	Nuk ka të dhëna
Të rinj të regjistruar në arsimin e lartë	Numri të rinjve (18-29) të regjistruar në Arsimin e Lartë/Numri total i të rinjve (18-29)	Numri i femrave të reja (18-29) të regjistruara në Arsimin e Lartë/Numri total i femrave të reja (18-29).	Numri i të rinjve meshkuj (18-29) të regjistruar në Arsimin e Lartë/Numri total i të rinjve meshkuj (18-29).	Informacioni i dhënë nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)
Të rinj të diplomuar në arsimin e lartë	Numri i të rinjve (18-29) të diplomuar në 2024 / Numri i të rinjve (18-29) të regjistruar në 2024	Numri i femrave të reja (18-29) të diplomuara në 2024 / Numri i të femrave të reja (18-29) të regjistruara në 2024	Numri i të rinjve meshkuj (18-29) të diplomuar në 2024/ Numri i të rinjve meshkuj (18-29) të regjistruar në 2024	Informacioni i dhënë nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)

DIMENSIONI I PJESËMARRJES SOCIALE	METODA E LLOGARITJES SË TË DHËNAVE			BURIMI I TË DHËNAVE
INDIKATORËT	TË DHËNA	FEMËR	MASHKULL	
Të Rinj të me Arsim të Avancuar	Numri i të rinjve (25-29) të diplomuar me master, doktoraturë ose diplomë ekuivalente / Numri total i të rinjve (25-29)	Numri i femrave të reja (25-29) të diplomuara me master, doktoraturë ose diplomë ekuivalente / Numri total i femrave të reja (25-29)	Numri i të rinjve meshkuj (25-29) të diplomuar me një master, doktoraturë ose diplomë ekuivalente / Numri total i të rinjve meshkuj (25-29)	Të dhëna të llogaritura nga hulumtuesi sipas të dhënave nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve dhe informacionit të disponueshëm në databazën e INSTAT
Shkalla e pjesëmarrjes në arsimin dhe trajnimin joformal (4 javët e fundit)	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Të dhëna të llogaritura dhe të siguruar nga INSTAT	Informacioni i dhënë nga Instituti Kombëtar i Statistikave në Shqipëri (INSTAT)
Buxheti i Qeverisë për Programet e Mbrojtjes Sociale	Shuma totale në lekë	Jo e Aplikueshme	Jo e Aplikueshme	Informacioni i dhënë nga Shërbimi Social Shtetëror

Projekti “Zëra më të Fortë për Zgjedhje më të Mira – Një Hub Rinor për BP&T implementohet nga:

